

1 E mërkurë, 28 tetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e  
6 seancës, ju lutem, paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Vërej për procesverbal që të gjithë të akuzuarit janë të  
13 pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit.

14 Sot do të dëgjojmë dëshmitarin e Prokurorisë me numër  
15 W04485.

16 Ju lutem të sillni dëshmitarin në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,  
19 Dëshmitar.

20 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi, juve. Mirëmëngjesi,  
21 përshëndetje të gjithëve. Përshëndetje bashkëluftëtarëve të  
22 mi.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja e  
24 seancës do t'ju japi tekstin e betimit solemn të cilin duhet  
25 ta lexoni në bazë të rregullores së Gjykatës. Ju lutem, lexoni

1 me zë të lartë dokumentin që keni përpara.

2 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime  
3 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të  
4 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe  
5 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

6 DËSHMITARI: FATMIR SOPI

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
8 tani mund të uleni.

9 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që  
10 mendohet se do të zgjasë përafërsisht një ditë. Në fillim do  
11 t'jua bëjë pyetjet Prokuroria, dhe pasi të përfundojë  
12 Prokuroria mund t'ju bëjnë pyetje ekipet e Mbrojtjes, por edhe  
13 Gjykatësit e Trupit Gjykses.

14 Prokuroria ka kërkuar një orë e gjysmë për pyetjet e  
15 veta. Ekipet e Mbrojtjes me përafërsi kanë kërkuar tre orë.  
16 Inkurajoj palët të jenë sa më të kujdesshëm në shfrytëzimin e  
17 kohës që u është caktuar. Trupi Gjykses mund të lejojë pyetje  
18 plotësuese nga ZPS-ja nëse përmbushen kriteret përkatëse.

19 Dëshmitar, përgjigjuni qartë me fjali të shkurtra. Nëse  
20 nuk e kuptoni një pyetje, lirisht thoni që nuk e kuptoni  
21 pyetjen, që ta sqarojmë.

22 Gjithashtu, na thoni ku i bazoni ju faktet dhe rrethanat  
23 për të cilat do t'ju bëjmë pyetje. Në qoftë se Prokuroria ju  
24 kërkon të flisni për korrigjimet që u keni bërë deklaratave  
25 tuaja, duhet të konfirmoni me zë për procesverbal që deklarata

1 juaj bashkë me korigjimet përkatëse pasqyron saktësisht  
2 dëshminë tuaj.

3 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara  
4 se të përgjigjeni, dhe ju lutem, flisni ngadalë për  
5 përkthyesit.

6 Gjatë kohës që jepni dëshmi në sallën e gjyqit, nuk duhet  
7 të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj jashtë  
8 sallës së gjyqit. Në qoftë se dikush jashtë sallës së gjyqit  
9 ju bën pyetje për dëshminë tuaj, ju lutem na njoftoni.

10 Dhe gjithashtu, mos flisni më nëse ua kërkoj unë këtë  
11 gjë. Dhe gjithashtu, mos flisni më nëse ngre unë dorën, sepse  
12 kjo do të thotë që unë duhet të jap një udhëzim.

13 Në çdo moment që keni nevojë për një pushim, na thuaj,  
14 dhe do të bëjmë organizimin përkatës.

15 Tani do të fillojmë me pyetjet nga Prokurori i  
16 Specializuar që është në të majtën tuaj. Ju lutemi, dëgjojeni  
17 me vëmendje.

18 Z. Prokuror, fjala është për ju.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

20 Pyetje nga z. Michalczuk:

21 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

22 PË. Mirëmëngjesi.

23 PY. Ne jemi takuar dhe më përpara, por sidoqoftë unë duhet të  
24 prezantohem sërish. Unë quhem Cezary Michalczuk dhe do t'ju  
25 bëj pyetje në emër të Prokurorisë sot.

1 Përpara se të fillojmë, duhet të na thoni identitetin

2 tuaj. Ju lutem, na thoni emrin dhe mbiemrin.

3 PË. Unë jam Fatmir Halim Sopi.

4 PY. Datëlindjen kur e keni?

5 PË. 13 prill 1961.

6 PY. Po vendlindja juaj cila është?

7 PË. Vendlindja ime është Mramor, lagjja Zllash.

8 PY. Dëshmitar, siç jua shpjeguar gjatë seancës përgatitore  
9 para ca ditësh, unë nuk do t'ju bëj pyetje për çdo aspekt të

10 mundshëm, sepse ekziston mundësia që t'i pranojmë nga

11 deklaratat paraprake ku gjendet ky informacion. Por sidoqoftë,

12 duhet të ndjekim disa hapa proceduralë dhe për këtë do të

13 duhet t'i zbatojmë që tani këto hapa.

14 Dëshmitar, a jeni intervistuar ndonjëherë nga ZPS-ja?

15 PË. Po.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I lutem Sekretares së seancës

17 të nxjerrë në ekran këtë dokument. Në anglisht dhe në shqip,

18 përbri njëri-tjetrit. Anglishtja me numër 069464-TR-ET, Pjesa

19 1 RED, faqja 1. Shqipja me të njëjtin numër, por me

20 prapashtesën AT, Pjesa 1 Revised RED, dhe në shqip faqja 1, ju

21 lutem.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Edhe një herë ju lutem,

23 ju lexuat numrin 069464, mos kishit fjalën për 474?

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, 474. Ju kërkoi ndjesë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe një herë

1 që të jemi të qartë, edhe shqipja edhe anglishtja përfundojnë  
2 me 474?

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Bëhet  
4 fjalë për numrin 069474.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, i shihni dokumentat që keni përpara në ekran?

8 PË. Po.

9 PY. A është kjo intervista juaj për ZPS-në?

10 PË. Po, e vërtetë.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund t'i hiqni dokumentet nga  
12 ekрани dhe të vendosni në ekran dokumentin me numër KSC-BC-  
13 2020-05 20220118 në anglisht, faqja 1. Dhe e njëjta gjë me  
14 shqipen, por që përfundon me ALB. Edhe në këtë rast faqja e  
15 parë.

16 PY. Dëshmitar, e është kjo dëshmia që keni dhënë ju në këtë  
17 Gjykatë?

18 PË. Po.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju lutem, hiqini këto faqe dhe  
20 vendosni dokumentet e fundit që do kenë numrin KSC-BC-2020-05  
21 20220119 në anglisht dhe e njëjta gjë dhe në shqip.

22 PY. Dëshmitar, a është kjo dëshmia që keni dhënë në Gjykatë?

23 PË. Po.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund t'i hiqni këto dokumenta

1 nga ekрани.

2 PY. Kur u përgatitët për dëshminë tuaj sot, a ju dhamë  
3 mundësinë t'i rishikonit dhe një herë këto deklaratata?

4 PË. Po.

5 PY. Gjatë seancës përgatitore, a ju dhanë mundësinë që t'i  
6 bënit disa korrigjime dhe disa sqarime këtyre deklaratave?

7 PË. Po.

8 PY. Ato sqarimet që bëre, a u hodhën në një shënim që më pas  
9 ta lexuam sërish?

10 PË. Gjithçka ishte në rregull. Nuk ka pas ndonjë përmirësim.

11 PY. Sqarimet që bëre a u hodhën në një shënim dhe më pas atë  
12 shënimin a ta lexuam sërish?

13 PË. Po, po, e vërtetë. Po.

14 PY. A konfirmoni se ajo që ne ju lexuam në atë shënim  
15 pasqyronte tërësisht dhe saktësisht ndryshimet tuaja?

16 PË. Po.

17 PY. Duke marrë parasysh tani dhe ndryshimet që lexuam tek ai  
18 shënimi, deklaratat a pasqyrojnë saktësisht atë që keni thënë  
19 asokohe, por që do të thoshit sërish sot në sallën e gjyqit?

20 PË. Po, gjithsesi.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, gjykojmë  
22 se kemi përmbushur kriteret e rregullës 154, dhe në përputhje  
23 me vendimin tuaj me numër F02655, paragrafi 34 dhe 49(b), i  
24 datës 16 tetor 2024, Prokuroria kërkon pranimin e të gjitha  
25 deklaratave në shqip dhe në anglisht.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
2 kundërshtime?

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime të  
4 reja, përveç atyre që kemi parashtruar tashmë.

5 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime të reja.

6 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime të reja.

7 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime të  
8 reja.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me  
10 numër 069747 [Sipas përkthimit] -- më falni, sa pjesë?

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Katër pjesë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
13 Katër pjesët pranohen.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti me numër  
15 069474 në shqip dhe në anglisht do të pranohen dhe do të  
16 marrin numrin P01766.1. Pjesa 2 me të njëjtin numër do të  
17 marrin numrin P01766.2. Pjesa 3 P01766.3. Pjesa 4 ka numrin  
18 P017766.4 [Sipas përkthimit].

19 Janë konfidenciale me sa shoh.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po. Dokumentet duhet të ruajnë  
21 klasifikimin konfidencial.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
23 KSC-BC-2020-05-0118 [Sipas përkthimit] në anglisht dhe në  
24 shqip pranohen.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin

1 P01767. Dhe duke qenë se vijimi është pjesë e dëshmisë,  
2 sugjeroj që t'i japim numrin .1 në fund.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, këtë do të propozoja edhe  
4 unë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull  
6 atëherë. KSC-BC-2020-05 2022-0119 dhe në anglisht dhe në shqip  
7 do të marrin numrin, të njëjtin numër me .2 në fund.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po. P0167.2 [Sipas  
9 përkthimit].

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do të doja që të kërkohej edhe  
11 Shënimi Përgatitor numër 1 me ERN 122310 [Sipas përkthimit]  
12 12334 [Sipas përkthimit] i 21 tetorit 2024.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
14 Materiali me numër 12310 [Sipas përkthimit] deri në 123334  
15 [Sipas përkthimit] pranohet.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë  
17 numrin P01768 [Sipas përkthimit].

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do kërkoja që të pranoheshin  
19 dhe provat materiale shoqëruese të evidentuara në paragrafin  
20 31 të vendimit tuaj me numër F02655.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
22 kundërshtim?

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo.

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Jo.

25 Z. TULLY: [Përkthim] Jo.



1 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Provat materiale shoqëruese me numrin përkatës do të pranohen.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti me numër,  
5 atëherë, U000-4319, U000-4321, bashkë me përkthimin në gjuhën  
6 angleze do të marrin numrin P01769.

7 Sa u takon pjesëve të tjera, tashmë ato janë pranuar si  
8 pjesë e provave gjyqësore dhe mbajnë numrin P187, që është në  
9 fakt libri i Zhitisë.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për ndërhyrjen.

11 Ne kemi pasur komunikim me njëri-tjetrin sa i takon numrit të  
12 fundit që u diskutua, dhe Prokuroria na ka garantuar që nuk do  
13 të kërkojnë që të pranohet i gjithë materiali pasi ka probleme  
14 me përkthimin në pjesën e fundit të këtij dokumenti.

15 Do të doja dhe një herë sqarim nga kolegu im i nderuar. A  
16 do t'i qëndrojnë kësaj dhe a do të pranojnë të gjithë?

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, është e vërtetë. Ne patëm  
18 diskutime me Mbrojtjen lidhur me këtë. Ka disa problematika me  
19 përkthimin me shkrim. Është lidhur me një urdhër të Brigadës  
20 153, prandaj për këtë arsye ne do të kërkojmë të pranohet  
21 vetëm ajo pjesë e dokumentit që nuk kontestohet nga Mbrojtja,  
22 përkatësisht që mban numrin U000-4319. Dy faqet e tjera të  
23 këtij materiali janë ende duke u rishikuar për shkak të  
24 përkthimit, dhe do të kërkoj më vonë që të pranohet pasi të  
25 përfundojmë çështjen e përkthimit.

1 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 Atëherë, dhe një herë. Ju po kërkon pranimin e  
4 dokumentit me numër U000-4319?

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
7 Pranohet.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë, më kërkon që  
9 t'i jap një numër të ri P01769 vetëm kësaj faqeje?  
10 Në rregull.

11 Më jepni ju lutem edhe klasifikimin për shënimin  
12 përgatitor dhe provën materiale shoqëruese.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Klasifikimi duhet të mbetet  
14 konfidencial, hë për hë.

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Duke qenë se dëshmitari ka dhënë  
16 dëshmi publike, a mund t'i kërkojmë Prokurorisë që të  
17 përgatisë një version të redaktuar publik të deklaratës së tij  
18 dhe të dëshmisë së tij që është pranuar sipas rregullës 154?

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sigurisht, sepse kjo është  
20 procedurë standarde.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më 21  
23 tetor 2024, Prokuroria dorëzoi një përmbledhje të dëshmisë së  
24 dëshmitarit që është pranuar tani sipas rregullës 154. Nuk  
25 kemi marrë kundërshtime lidhur me këtë, kështu me lejen tuaj

1 do të doja të lexoja me zë një përmbledhje të shkurtër në  
2 seancë të hapur.

3 Fatmir Sopi u kyç në UÇK në fillim të 1998. Ai ka qenë i  
4 angazhuar në organizimin e strukturave të UÇK-së në regjionin  
5 e Gollakut, brenda zonës operative të Llapit dhe ka qenë  
6 person i rëndësishëm në krijimin e Brigadës 153, Fehmi  
7 Lladrovci. Në shkurt 1999 u emërua si komandant i Brigadës  
8 153, përgjegjës për mbrojtjen e civilëve. Më pas, në mes të  
9 prillit 1999, u emërua zëvendëskomandant i brigadës dhe ka  
10 marrë pjesë në luftimet kundër forcave serbe.

11 Z. Sopi, ka qenë në brigadë në këtë pozitë pra, si  
12 zëvendëskomandant i brigadës, deri në momentin e demobilizimit  
13 të UÇK-së në shtator 1999.

14 Z. Sopi jep informacione lidhur me krijimin, strukturën,  
15 stërvitjen dhe operacionet e Brigadës 153, njërive të tjera  
16 UÇK që operonin në atë zonë, përfshirë BIA-n, vijat e  
17 raportimit me zonën operative të Llapit dhe vendet e UÇK-së,  
18 vendndodhjet e UÇK-së në atë rajon.

19 Të nderuar Gjykatës, tani kam disa pyetje të tjera për  
20 këtë dëshmitar.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
22 vazhdoni.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

24 I lutem Sekretares së seancës të vendosë fillimisht në  
25 ekran dokumentet vijuese, U000-9023-U000-9023. Kjo është në

1 shqip. Dhe do ju lutesha përbri të vendosnit dhe anglishten që  
2 ka prapashtesën ET.

3 PY. Z. Sopi, këtë dokument që keni përpara, a e keni parë  
4 ndonjëherë?

5 PË. Po, në seancën përgatitore.

6 PY. Z. Sopi, a e keni lëshuar ju këtë kërkesë?

7 PË. Nuk ka qenë vetëm kjo kërkesë. Ne kemi lëshuar kërkesa të  
8 tilla edhe herë të tjera, kështu që, po. E arsyeshme është  
9 kjo. Kërkesë për furnizim.

10 PY. Pra, e konfirmoni që të paktën këtë kërkesë që shohim në  
11 ekran e keni lëshuar ju?

12 PË. Po.

13 PY. Z. Sopi, nënshkrimi në fund, a është i juaji?

14 PË. Afërsisht ka pak dallime, por mund, koha, por afërsisht,  
15 po. Mund koha ma e lashtë që e kam nënshkru, mirëpo, e  
16 konfirmoj.

17 PY. Shkurtimisht, a mund t'i tregoni Trupit Gjykses çfarë  
18 është ky dokument?

19 PË. Kjo dokument është kërkesë për furnizimin e njësive tona  
20 me armë dhe municione të cilat ishin mungesë në rajonin tonë,  
21 sepse ne nuk kishim mundësi që të furnizohemi prej furnizimeve  
22 që kishim. Dhe kërkesa jonë ishte që të pajisemi sa ma mirë me  
23 armatim sepse pritnim çdo herë ndonjë ofensivë ose ndonjë sulm  
24 nga forcat serbe sepse i vërenim lëvizjet e tyre dhe donim që  
25 të jemi sa ma të përgatitun dhe të kërkojmë ndihmë nga kolegët

1 tanë.

2 PY. A e kuptova unë siç duhet përgjigjen tuaj, se nuk ka qenë  
3 e vetmja kërkesë kjo që keni lëshuar ju në zonën operative të  
4 Llapit asokohe?

5 PË. Po, kemi pas kërkesa të herëpashershme të kësaj natyre  
6 për furnizim, normal. Por edhe për furnizim me ushqime, me  
7 materiale të nevojshme për vazhdimin e luftës.

8 PY. Thatë që keni lëshuar të tilla kërkesa edhe në të  
9 shkuarën. Po për cilat vite e keni fjalën?

10 PË. E kam fjalën ma vonë, jo për më herët. Por e kam fjalën  
11 gjatë luftës. Ne kemi bashkëpunu, domethënë me, edhe me njësi  
12 të tjera.

13 PY. Keni fjalën për 1998 dhe 1999?

14 PË. Po.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I lutem Sekretares t'i heqi  
16 dokumentet nga ekrani.

17 Të nderuar Gjykatës, fillimisht do të doja që të  
18 pranoheshin këto dokumente.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë  
20 kundërshtim?

21 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

22 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

23 Z. TULLY: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

24 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 U000-9023, U000-9023, dhe në anglisht dhe në shqip pranohen.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë, dokumenti do  
3 të marrë numrin P01770, por ju lutem më jepni dhe  
4 klasifikimin.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Klasifikimi do të jetë publik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
7 riklasifikojeni si publik.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju lutem të vendosni një  
9 dokument tjetër në ekran, SITF00244127-SITF00244127-ET, edhe  
10 shqipja me të njëjtin numër.

11 PY. Dëshmitar, a i shihni dokumentet që keni përpara në  
12 ekran?

13 PË. Po.

14 PY. Çfarë janë këto dokumente, mund t'i thoni Trupit Gjykses?

15 PË. Po, pas përfundimit të luftës, ushtarët tanë kanë kalu në  
16 jetën civile ose në institucionet e tjera të shtetit, si në  
17 polici, në TMK e në organizata të tjera edhe ndërkombëtare që  
18 punonin në Kosovë. Dhe në ato institucione ju kërkohej një  
19 vërtetim se a kanë qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të  
20 Kosovës. Dhe ne deri në verifikimin që është bërë nga qeverisë  
21 e Republikës së Kosovës kemi lëshu dokumente të tilla të cilat  
22 vërtetojnë pjesëmarrjen e dikuj, për shembull të këtij ushtari  
23 në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Dhe kjo në rastin konkret  
24 iu ka lëshu personit që të jetë pjesë e policisë së Kosovës.  
25 PY. Nënshkrimin e këtij dokumenti a e njihni?

1 PË. Po. Po.

2 PY. Kush e ka nënshkruar, i kujt është?

3 PË. Për këtë dokument e shoh se është nënshkruar nga unë dhe  
4 nga Adem Shehu.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund t'i heqim dokumentet nga  
6 ekrani.

7 Të nderuar Gjykatës, do kërkoja që të pranoheshin dhe  
8 këto dokumente si pjesë e provave gjyqësore.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
10 kundërshtime?

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

12 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk e kuptojmë çfarë relevance ka  
13 kjo për çështjen e Prokurorisë.

14 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi asnjë kundërshtim tjetër.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi  
16 rrëzohet. Dokumenti SITF00244127 deri në SITF00244127-ET  
17 pranohet sepse është relevant edhe i vlefshëm sipas rregullës  
18 138(1) dhe 154.

19 Marrin numrin përkatës.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë  
21 numrin P01771, dhe ju lutem më jepni klasifikimin.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do të jetë klasifikimi publik.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

24 Riklasifikojeni si dokument publik.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I lutem tani Sekretares së

1 seancës të nxjerrë në ekran dokumentin me numër U000-4205-  
2 U000-4206-ET, edhe shqipja mban të njëjtin numër. Ju lutem,  
3 dokumentet të shfaqen përbri njëri-tjetrit.

4 PY. Dëshmitar, i shihni dokumentet përpara në ekran?

5 PË. Po.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë në fund, në  
7 faqen e fundit të këtij dokumenti në shqip.

8 PY. Z. Sopi, a e njihni nënshkrimin e Adem Shehut në këtë  
9 dokument?

10 PË. Po, afërsisht është nënshkrimi, besoj, i Adem Shehut.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mundet të kalojmë në faqen e  
12 parë përsëri në shqip dhe në anglisht, ju lutem?

13 PY. Z. Sopi, në këtë dokument në fillim fare përmenden disa  
14 njësi të UÇK-së. Brigada 153 a ka pasur njësi në këto vende,  
15 në Vijë, në Gërbesh, në Bullaj, në Viti dhe në Vakovc?

16 PË. Po.

17 PY. Këtë dokument neve e diskutuam dhe gjatë seancës  
18 përgatitore, a të kujtohet kjo, z. Sopi?

19 PË. Po. Po.

20 PY. Ky dokument flet për prita të caktuara që ishin  
21 planifikuar nga Brigada 153 në dy rrugë, në Viti dhe në  
22 Bullaj. A është e ky rasti, është kështu?

23 PË. Po. Po, po.

24 PY. Pritat që përmenden në këtë dokument, a janë planifikuar,  
25 a janë organizuar dhe a janë ekzekutuar nga njësitë e Brigadës



1 153, z. Sopi?

2 PË. Unë me sa e di në këtë periudhë unë personalisht kam qenë  
3 në luftime në zonën e Prapashticës, në drejtim me kufirin e  
4 Serbisë kur më 7 prill 1999, njësi të motorizuara dhe me  
5 artileri dhe këmbësori, mësynë të hyjnë në territorin e  
6 Republikës së Kosovës, më konkretisht në vendin ku e  
7 kontrollonte Brigada 153, në rrugën që shpie nga Leskovci në  
8 Prishtinë. Unë kam qenë komandant i operacioneve të asaj zone  
9 në këtë kohë dhe kam kërkuar edhe e kam ndërpre atë depërtimin  
10 e forcave serbe dhe kam kërkuar nga komanda e Brigadës 153 që  
11 të më sigurojë prapashpinën sepse kisha indikacione që mund do  
12 të ketë sulme edhe nga drejtimi i Gjilanit, Prishtinës apo  
13 Podujevës.

14 Dhe për këtë qëllim komanda e brigadës ka lëshuar këtë  
15 urdhër se edhe ato njësi nga drejtimi që vije nga Gjilani, të  
16 jenë në gjendje gatishmërie dhe të mbrojnë prapashpinën e  
17 luftimeve tona që ishin të koncentruara në Prapashticë,  
18 Dabishevc, Nishevc, dhe Hajkobillë. Këtu ne kishim formuar një  
19 vijë të fortë mbrojtëse dhe e përballuam atë sulm deri në 18  
20 prill kur vërtet nga këto pozicione që flitet këtu, ne patëm  
21 sulmin nga të gjitha anët, nga drejtimi i Gjilanit,  
22 Prishtinës, Podujevës, si dhe në drejtimin e Serbisë që ishin  
23 veç në operacione luftimi.

24 Kjo ishte arsyeja e këtij urdhri, të cilin unë në atë  
25 kohë nuk e kam parë, sepse kam qenë i nxënë, mirëpo tash po e

1 shoh dhe po e shoh shumë, shumë mirë, dhe kanë ekzistuar këto  
2 prita dhe në këto pika janë bërë luftime të ashpra.

3 PY. Pra, përgjigjja ndaj pyetjes time shkurtimisht me pak  
4 fjalë do ishte po, kështu, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 PY. Ky dokument diskuton gjithashtu edhe përgatitjet sa i  
7 takon logjistikës, komunikimeve dhe kujdesit shëndetësor. A  
8 është bërë përgatitja sikurse përshkruhet në këtë dokument,  
9 Dëshmitar?

10 PË. Po normal, ne në brigadën tonë kemi pas edhe njësinë e  
11 sanitetit ose të mbrojtjes shëndetësore, dhe kemi pas njësi të  
12 caktuara, ushtarë të cilët janë marrë edhe me logjistikë, dhe  
13 kemi qenë të furnizuar dhe të përgatitur në mal për betejat të  
14 ardhshme që kanë rezultuar pozitive sepse më 18 prill --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
16 një çast.

17 Z. Tully, fjala për ju.

18 Z. TULLY: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë sepse doja të bëja  
19 një korigjim për transkriptin. Në faqen 15, rreshti 18, kam  
20 përshtypjen që viti është i pasaktë. A mund ta sqarojë  
21 Prokurori pak vitin?

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, në fakt i nderuar Gjykatës.  
23 Po, thuhet që luftimet u zhvilluan më datë 7 tetor 1999. Mund  
24 ta sqarojmë me dëshmitarin për të na e saktësuar.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

1 z. Tully.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

3 PY. Së pari, ju kërkoj ndjesë që ju ndërpreva, Dëshmitar.

4 Gjithsesi duhet të sqarojmë diçka. Kur po diskutonit për  
5 betejën në të cilën ishit i përfshirë përpara pak çastesh, ju  
6 përmendët datën 7 tetor 1999, por me ç'kuptoj unë, ju e keni  
7 pas fjalën për 1998, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Jo, 7 prill.

9 PY. Prill, jo tetor?

10 PË. Beteja në Prapashticë dhe në drejtim të kufirit me  
11 Serbinë ka ndodh më 7 prill 1999.

12 PY. Domethënë muaji nuk është i saktë, viti është i saktë,  
13 kështu?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

16 PY. Ju ndërpreme, Dëshmitar. Kështu që ju lutem vazhdoni dhe  
17 jepini përgjigjen e plotë pyetjes time të fundit. Çfarë po  
18 thonit përpara se t'ju ndërprisja, kështu që mund ta  
19 përfundoni, nëse doni.

20 PË. Jo, unë e përfundova. Ajo, ato vërejtje dhe ato masa kanë  
21 qenë efikase dhe kanë dhanë rezultat në betejën ose në  
22 ofensivën e përgjithshme që ka ndodh më -- 18 prill 1999, ku  
23 në mesin tonë kishte një numër shumë të madh të popullatës  
24 civile e dëbuar nga Prishtina, Podujeva, dhe nga zonat e tjera  
25 të luftës të cilët po qëndronin në Prishtinë. Forcat serbe

1 morën një dëbim masiv të këtyre qytetarëve nga Prishtina,  
2 Podujeva, në drejtim të Gollakut.

3 Ku popullata e kësaj ane e mirëpriti dhe i sistemuan dhe  
4 i ndihmuan që ata të sistemojnë, i morën në mbrojtje në  
5 mundësitë që kishin. E gjithë, e gjithë Ushtria Çlirimtare e  
6 Kosovës në atë kohë u mor ma tepër tani me sistemimin dhe me  
7 mbrojtjen e këtyre civilëve të cilët pa asgjë ishin përzënë në  
8 shtëpitë e tyre nga Prishtina dhe Podujeva dhe me rrethinë. Ne  
9 morëm masa po ashtu dhe rezervat tona që i kishim për nevojat  
10 e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i lëshuam në shërbim të  
11 qytetarëve që të mos na ngelnin pa ushqime, pa bukë.

12 Mirëpo, më 18 prill, më 18 prill filloi një ofensivë e  
13 përgjithshme e forcave serbe e cila nuk kursente as civilët.  
14 Dhe ndodheshim përballë një beteje e cila ishte për jetë a  
15 vdekje. Ne morëm masat maksimale për mbrojtjen e civilëve,  
16 mirëpo forcat serbe përdorën artilerinë dhe për katër ditë  
17 rresht kanë granatuar dhe kanë qëlluar me topa, minahedhëse  
18 mbi pozicionet tona, por edhe mbi civilët, ku kemi pas humbje  
19 të mëdha.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të  
21 kalojmë deri në fund fare, në fjalinë e fundit të këtij  
22 dokumenti, si në shqip ashtu dhe në anglisht.

23 PY. Z. Sopi, në rreshtin e fundit të këtij dokumenti, flitet  
24 për "vendkomandën e ...", edhe për "lartësinë 1210". Çfarë do  
25 me thonë kjo "lartësia 1210"? Mund të na e thuash dot?

1 PË. Kjo domethënë lartësia mbidetare e fshatit Zllash, është  
2 1210, 1-2-1-0, lartësia mbidetare. Dhe është konfirmu për  
3 shkak të me ra në dorë të armikut më afërisht domethënë me  
4 mbet kjo konfidencial, me ditë vetëm ne që ishim ushtarakë të  
5 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që ku është vendkomanda për  
6 momentin. E cila vazhdimisht ka qenë aty. Është fjala pra për  
7 fshatin Zllash, 1210 metra lartësia mbidetare është marrë.

8 PY. Për ta sqaruar, flitet për vendkomandën e Brigadës 153,  
9 që gjendet në këtë lartësi?

10 PË. Po.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk do  
12 kërkoj që të pranohet ky dokument në prova tani, sepse ky  
13 dokumenti që e diskutuam dhe më përpara, por siç e diskutuam,  
14 do presim që përkthimi të jetë në rregull dhe pastaj të mund  
15 ta shtojmë këtë dokument në prova gjyqësore.

16 Mund ta heqim këtë dokument nga ekрани tani.

17 Tani, do i kërkoj Sekretares të paraqesë një video, është  
18 një dokument në versionin në video. Për procesverbal është  
19 dokumenti 065503-01 dhe në qoftë se është e mundur nga aspekti  
20 teknik, do kërkoja që të paraqitet gjithashtu edhe transkripti  
21 që ka të njëjtin numër dhe që përfundon me TR-ET. Shumë pak  
22 fjalë thuhet në video, më shumë jam i interesuar për imazhin,  
23 për pamjen që paraqitet në këtë, kështu që nuk do jetë problem  
24 për përkthyesit për ta ndjekur dhe në qoftë se nuk e shfaqni  
25 transkriptin.

1 PY. Z. Sopi, hidhini një sy kësaj videoje, është një video  
2 shumë e shkurtër. Domethënë dëgjojeni videon fillimisht dhe  
3 pastaj do ju bëj disa pyetje lidhur me të.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Transmetojeni ju lutem,  
5 Sekretare. Po, kjo është videoja.

6 [Luhet videoincizimi]

7 "Togu, gati-tu. Djathtas, majtas [E pakuptueshme]. Për  
8 nder, armë. Z. Ministër, truproja e nderit ndodhet e rreshtuar  
9 me rastin e ardhjes tuaj. Komandanti i truprojës [E  
10 pakuptueshme].

11 "[E pakuptueshme] Si jeni? [E pakuptueshme]. Mirë?

12 "[E pakuptueshme] qetash [E pakuptueshme] hala janë në  
13 kufi. [E pakuptueshme]."

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

15 PY. Z. Sopi, a e njihni këtë vendin ku është bërë xhirimi?

16 PË. Po.

17 PY. Cili është ky vend?

18 PË. Në Prishtinë, në lagjen Kolovicë e Re, ku ishte i  
19 vendosur shtabi i zonës operative të Llapit.

20 PY. Në çfarë periudhë mund të jetë bërë ky xhirim?

21 PË. Siç duket, në periudhën pas përfundimit të luftës, pas  
22 hyrjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave të KFOR-  
23 it në Prishtinë.

24 PY. Çfarë ju bën të mendoni këtë gjë që ka qenë në këtë  
25 periudhë?

1 PË. Kjo çka pashë më ngjall emocione sepse ma kujton  
2 zëdhënësin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, njeriu i cili i  
3 jepte zë dhe i jepte shpirt dhe zemër çdo luftëtari në luftën  
4 tonë çlirimtare, të nderuar Jakup Krasniqi, i cili në cilësinë  
5 e një ministri bën një vizitë në shtabin e zonës operative të  
6 Llapit.

7 PY. Një prej personave që ju njihni nga kjo video është z.  
8 Krasniqi, Jakup Krasniqi, që është një prej të akuzuarve në  
9 këtë çështje. Është e vërtetë kjo?

10 PË. Është e vërtetë që është Jakup Krasniqi, dhe nuk do të  
11 doja kurrë ta shihja në këtë sallë dhe në këtë gjendje.

12 PY. Po personi me uniformë që e përshëndet z. Krasniqi, kush  
13 është në qoftë se e njihni?

14 PË. Personi që komandon këtu po thotë se është Ajet Potera,  
15 ndërsa personi që përshëndetet me z. Krasniqi është komandanti  
16 i zonës operative të Llapit, Rustem Mustafa, Remi.

17 PY. Pra personi i parë që e përshëndet z. Krasniqi është  
18 Potera, dhe pastaj pas atij është Rustem Mustafa, këtë po  
19 thonit?

20 PË. Po.

21 PY. Të flasim për z. Potera, në atë kohë çfarë posti ka pasur  
22 z. Potera në UÇK?

23 PË. Nuk jam i sigurt, këtu në këtë video shoh se është duke  
24 komanduar me një tog të Batalionit 5 Gardist të zonës  
25 operative të Llapit.

1 PY. Cili ka qenë, çfarë ka qenë Batalioni i Gardës?

2 PË. Nuk kam njohuri të matutjeshme, vetëm e di se ka ekzistuar.

3 PY. A ka pasur ndonjë funksion ai brenda zonës operative të  
4 Llapit, Dëshmitar?

5 PË. Nuk kam njohuri.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që  
7 këtë video të pranohet si provë gjyqësore së bashku me  
8 transkriptin në shqip dhe në anglisht. Atëherë, për  
9 procesverbal, videoja ka numër identifikimi 065503-01,  
10 transkripti në shqip është 065503-01-TR, dhe përkthimi i  
11 transkriptit në anglisht është 065503-01-2678-TR-ET [Sipas  
12 përkthimit].

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë  
14 kundërshtim?

15 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kundërshtojmë për  
16 videon, për pranim, por për transkriptin, po, kundërshtojmë,  
17 sepse aty ku thuhet që është e padëgjueshme, në transkript  
18 përkthyesi në këtë gjykatë në fakt dha përkthimin e asaj çfarë  
19 e dëgjua në video, që është për procesverbal.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë person  
21 tjetër, ndonjë palë tjetër që ka kundërshtim?

22 Kundërshtimi pranohet -- rrëzohet, më falni. Atëherë,  
23 dokumenti 065503-01, plus transkripti në shqip dhe në  
24 anglisht, që kanë numrin 065503-01-ET, pranohen në prova  
25 gjyqësore.



1           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do  
2 marri numrin e provës P01772. A mund të konfirmoni  
3 klasifikimin, në qoftë se bëhet fjalë për klasifikim publik të  
4 dokumentit siç është në *Legal Workflow*?

5           Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, të njëjtin klasifikim mund  
6 të ruani.

7           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Domethënë, të jetë  
8 publik apo konfidencial?

9           Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, më mirë publik.

10          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
11 vazhdoni.

12          Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

13 PY. Z. Sopi, në deklaratën që i keni dhënë ZPS-së që është në  
14 provën P01766.2, në faqen 14, dhe në deklaratën që keni dhënë  
15 në Gjykatë, në provën P01767.1, në faqen 2033, ju keni  
16 përmendur njësinë e Karadakut që ka qenë e pranishme në Zllash  
17 rreth vitit, domethënë në 1998, pak a shumë. A mund të na  
18 thoni kush kanë qenë komandantët e zonës operative të  
19 Karadakut?

20 PË. Komandanti i zonës operative të Karadakut ka qenë Ahmet  
21 Isufi, ndërsa zëvendës i tij ka qenë Shemi Syla.

22 PY. Ata të dy kanë qëndruar për një periudhë kohe në Zllash,  
23 apo jo? Gjatë luftës e kam fjalën.

24 PË. Po, kanë qëndruar.

25 PY. Në çfarë periudhe kanë qëndruar, në qoftë se ju kujtohet?

1 PË. Besoj kah përfundimi i vitit 1998, deri në fillim të  
2 vitit 1999. Gjatë, në q'atë periudhë kohore.

3 PY. A je takuar ti me ata atje në Zllash në atë kohë?

4 PË. Po, jam takuar në shtëpinë time.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare e seancës, do  
6 kërkoja që të paraqisni në ekran tani një dokument që ka  
7 numrin SPOE00222690-00222690.

8 PY. Z. Sopi a shikoni ju një fotografi në ekran?

9 PË. Po, e shikoj.

10 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues në qoftë se njihni  
11 ndokënd në këtë fotografi?

12 PË. I njoh që të gjithë. I njoh që të gjithë.

13 PY. Ju lutem, a mund t'i thoni Trupit Gjykues se kë njihni?

14 PË. Në këtë foto është ulur Ahmet Isufi, afër tij është Salih  
15 Mustafa. Ndërsa në këmbë jam unë, Fatmir Sopi dhe Shemsi Syla.

16 PY. Për ta sqaruar, a mund të na thoni që ju a keni qenë në  
17 pozicion në UÇK, a mund të na thoni se çfarë pozicioni keni  
18 pas në UÇK [Sipas përkthimit]?

19 PË. Unë?

20 PY. Ju jeni në këmbë këtu te fotografia? Domethënë, jeni me  
21 këtë kapelën?

22 PË. Po, po. Po, po. Në këmbë. Në anën e djathtë.

23 PY. Domethënë, ky personi që është ngjitur me ju, ky që është  
24 ulur, domethënë që nuk është ulur, por që është ngjitur me  
25 juve, si e ka emrin, mund të na e thoni dhe një herë tjetër?

1 PË. Shemsi Syla. Shemsi Syla. Shemsi Syla.

2 PY. Domethënë, Shemsi Syla--

3 PË. Po. Po.

4 PY. -- ka qenë zëvendëskomandant i zonës së Karadakut. Kështu  
5 i takon, apo jo? Po personi që është me këtë automjetin, me --  
6 më falni, me armën që është poshtë jush, domethënë që e ka,  
7 kush është ky personi, na e sqaroni pak?

8 PË. Ai është Ahmet Isufi, komandanti i zonës operative të  
9 Karadakut.

10 PY. Po personi që është ngjitur me të, kush është? Që ka këtë  
11 beretën, këtë kapelën?

12 PË. Personi që është ngjitur me të, është bashkëluftëtari  
13 ynë, Salih Mustafa.

14 PY. Z. Sopi, ku është bërë kjo fotografi?

15 PË. Nuk më kujtohet, unë këtë fotografi nuk e kam. Dikush e  
16 ka shkrepë, ne kemi dalë, por vendi nuk më kujtohet. Me siguri  
17 në Zllash, por vendi nuk më kujtohet.

18 PY. Pra, është fotografi që është bërë në Zllash, por ty nuk  
19 të kujtohet ekzaktësisht në çfarë vendi është bërë, domethënë  
20 nuk të kujtohet vendi, shtëpia, nuk e di unë, godina ku është  
21 bërë fotografia, këtë po thoni? Është e saktë kjo?

22 PË. Po.

23 PY. Kur është bërë kjo fotografi, z. Sopi?

24 PË. Nuk muj me e përcaktu, nuk muj me e dit. Kohën nuk muj me  
25 e dit. Gjatë luftës, por kohën nuk mundem me e dit, se nuk ka

1 qenë relevante ta mbaj mend, nuk ka qenë e rëndësishme kjo.

2 Dikush e ka shkrep këtë fotografi. Unë këtë fotografi, për  
3 shembull, nuk e kam. Kisha pas dëshirë me e pas.

4 PY. Përpara pak minutash, ju thatë që jeni takuar me Shemsi  
5 Shoralakun [Sipas përkthimit] dhe Ismet Isufin [Sipas  
6 përkthimit] gjatë periudhës së fundit të 1988 [Sipas  
7 përkthimit], fillimit të 1999. A mendoni që ndoshta mund të  
8 jetë bërë gjatë kësaj periudhe kohore kjo fotografi?

9 PË. Mund, mund. Gjatë asaj kohe, mund të jetë bërë.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që  
11 kjo fotografi të pranohet në prova materiale gjyqësore.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
13 kundërshtime?

14 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo.

15 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Relevanca.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
18 SPOE00222690 deri në 00222690, fotografia pra, pranohet në  
19 prova gjyqësore.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do  
21 të marrë numrin e provës P01773. Ju lutemi, klasifikimin, cili  
22 është?

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për momentin klasifikimi është  
24 konfidencial.

25 PY. Z. Sopi, do flas përsëri për temën e ushtarëve të

1 Karadakut. Ushtarët e Karadakut, a kanë luftuar bashkë me  
2 ushtarët e Brigadës 153?

3 PË. Po. Në ofensivën e 18 prillit normal që kemi qenë në të  
4 njëjtat pozicione zjarri, dhe na u kanë bashkangjitur në  
5 luftime.

6 PY. Prill të 1999?

7 PË. Po, në prill të 1999.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare e seancës, do ju  
9 kërkoja që të hiqnit fotografinë që është në ekran, dhe në  
10 vend të saj të paraqitet një dokument, numri i tij i  
11 identifikimit është SPOE00055678-SPOE00055601-ET [Sipas  
12 përkthimit]. Dokumenti në shqip ka të njëjtin numër. Kërkoj që  
13 në ekran të paraqiten faqet 494 -- ju kërkoj ndjesë, 944 dhe  
14 950. Të fillojmë nga 949. Atëherë, numri i plotë SPOE për këtë  
15 dokument është SPOE00055949, në të dyja versionet.

16 PY. Po ju tregoj një fletë, një faqe, nga një libër që kemi  
17 diskutuar gjatë seancës përgatitore. Po jua tregoj këtë fletë  
18 të librit thjesht sa për t'ju referuar periudhës së kohës që  
19 ka të bëjë me paragrafin që ju tregova pak më përpara.  
20 Domethënë, është kohë që zgjat nga 20 deri në 31 prill 1999. E  
21 shikon këtë, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në faqen  
24 tjetër pas kësaj.

25 PY. Z. Sopi, paragrafi i tretë është si në vijim:

1 "Luftime të rrepta u zhvilluan edhe në ditët në vazhdim.  
2 Gjatë ditës së tretë të betejës, gjatë luftimeve njësitet e  
3 Brigadës 153, njësitet e gueriles BIA dhe ato të zonës  
4 operative të Karadakut qëndruan të pathyera në pozicionet e  
5 tyre."

6 A konfirmoni se është i saktë ky paragraf, të paktën për  
7 pjesën e luftimeve që njësitet e Brigadës 153 kanë luftuar  
8 bashkë me guerilen BIA dhe të zonës operative?

9 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kundërshtojmë mënyrën se si u bë  
10 pyetja, sepse pyetja është sugjestionuese.

11 Prokurori mund t'ia bëjë pyetjen nëse ka marrë vetë ai  
12 pjesë ai në këtë betejë, por jo t'ia sugjerojë dhe t'ia  
13 diktojë mënyrën se si duhet të përgjigjet.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.  
15 Vazhdoni.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

17 PY. Z. Sopi, a mund t'i përgjigjeni pyetjes?

18 PË. Urdhnoni. Urdhno pyetja.

19 PY. Do ta përsëris dhe një herë pyetjen. Pra, ky paragrafi që  
20 sapo lexuam, a është i saktë sa i përket asaj pjesës që ju  
21 keni luftuar së bashku me Brigadën 153, zonën e Karadakut dhe  
22 njësitin BIA në këtë betejë, është e saktë kjo pjesë?

23 PË. Kjo ka të bëjë me ofensivën e madhe të 18 prillit 1999,  
24 kur forcat e mëdha ushtarake, policore edhe paramilitare kanë  
25 sulmuar nga të katër anët njësitet tona dhe popullatën civile

1 e cila ndodhej nën mbrojtjen tonë. Në ato luftime, janë  
2 përfshi të gjitha njësitet e Brigadës 153, të gjitha njësitet  
3 e zonës operative që kanë qenë prezent në regjionin tonë. Po  
4 ashtu kanë marrë pjesë edhe njësitet e gueriles BIA. Kjo është  
5 e vërtetë.

6 PY. Dhe të Karadakut, edhe ushtarët e Karadakut?

7 PË. Po, e vërtetë. Po.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj  
9 pranimin e këtyre dy faqeve si pjesë e provave gjyqësore.  
10 Faqen e parë për të cilën komentoi dëshmitari dhe të dytën ku  
11 u dha periudha kohore.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
13 kundërshtime?

14 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

15 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

16 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

17 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për sqarim, vetëm diçka. Kjo  
19 është një pjesë e librit që është pranuar tashmë si provë  
20 gjyqësore. Por ne thjesht duam që t'i bashkëngjiten këto dy  
21 faqe provës me numër P00187-ET dhe shqipja që ka numrin  
22 P00187, pra të dyja versioneve.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me  
24 numër SPOE000555678 [Sipas përkthimit] deri në SPOE0056018-ET  
25 në anglisht dhe në shqip në faqet 949, 950, do t'i

1 bashkëngjitet provës materiale me numër P00187.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Tani, të shohim të njëjtin  
5 dokument, por të kalojmë në faqen SPOE00055794-ET. Ju lutem,  
6 të vendosni përbri edhe shqipen që në fakt përmban të njëjtin  
7 numër.

8 PY. Z. Sopi, edhe kjo është një pjesë e librit që diskutuam  
9 gjatë seancës përgatitore. Ju lutem, të shohim paragrafin e  
10 parë, këtu ku flitet "pas rajonit të Besjanës" -- "pos rajonit  
11 të Besjanës", ku diskutohen zhvillimet e njësive në Prishtinë  
12 në Fushë-Kosovë, dhe Kastriot, në zonën e Kastriotit. Këtu  
13 përmenden dhe disa persona, mes të cilëve është dhe emri juaj,  
14 z. Sopi. E shihni emrin tuaj?

15 PË. Po.

16 PY. Z. Sopi, ju përmendeni si një nga organizatorët e  
17 strukturave të UÇK-së në mars e në prill 1998. A konfirmoni ju  
18 se kanë ekzistuar këto njësive të UÇK-së në vendet që  
19 përmenden në këtë paragraf? Më konkretisht, bëhet fjalë për  
20 regjionin e Besjanës, të Prishtinës, Fushë-Kosovës, dhe  
21 Kastriotit. Kanë ekzistuar?

22 PË. Për regjionin e Prishtinës, Kastriotit dhe Fushë-Kosovës  
23 kur flitet këtu, unë në atë kohë nuk kam pas njohuri. Unë,  
24 emri im këtu figuron, por sepse unë kam pas përgjegjësinë  
25 organizative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në regjionin e



1 Gollakut, i cili regjioni është malësia e Prishtinës, do të  
2 thotë, pjesa rurale e territorit të Prishtinës, në drejtim,  
3 deri në kufi me Serbinë. Ndërsa për këtu që flitet për  
4 organizime të tjera në Prishtinë, në Kastriot e të tjera, unë  
5 nuk, nuk kam marrë pjesë në ato -- në organizimin e atyre  
6 njësiteve.

7 PY. Dua të flasim për pjesëmarrjen -- nuk dua të flasim vetëm  
8 për pjesëmarrjen, por për njohurinë. Pra, asokohe, a ka pasur  
9 qeliza të UÇK-së në këto vendndodhje, siç përmendet këtu?

10 PË. Fillet e organizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës  
11 kanë qenë me, janë bërë me, organizimet janë bërë me kujdesin  
12 ma të madh maksimal që të mos kemi, domethënë, ndonjë sulm të  
13 papritur që në embrion, të dëmtohen njësitet tona. Dhe ato  
14 kanë shku në mënyrë pak konfidenciale dhe unë në atë kohë nuk  
15 i kam dit organizimet që i kanë bërë të tjerët, sepse nuk kam,  
16 nuk kemi dhënë sqarime për këto sende.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund ta  
18 ndihmoj dëshmitarin me kujtesën?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 [Përkthim] Po. Mund t'ia rifreskoni kujtesën dhe pastaj  
21 do të bëjmë një pushim të shkurtër.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në rregull.

23 PY. Z. Sopi, unë do t'ju tregoj Shënimin përgatitor numër 2.  
24 Do t'ju lexoj unë diçka që keni thënë lidhur me këto vendet që  
25 përmenda, dhe zhvillimet e njësiteve të UÇK-së. Jua treguam

1 saktësisht këtë faqe të dokumentit gjatë seancës përgatitore  
2 dhe ju thatë:

3 "Kisha dijeni për strukturat të UÇK-së në regjionet e  
4 Besjanës, Podujevës, Prishtinës, Fushë-Kosovës dhe Kastriotit  
5 në -- mars, prill të 1998 [Sipas përkthimit] dhe se kanë qenë  
6 nën -- dhe se Fatmir Humolli ka pasur një rol të spikatur,  
7 pra, të rëndësishëm, në këto përpjekje, për zhvillimin e  
8 tyre."

9 A e keni thënë këtë gjatë seancës përgatitore?

10 PË. Nuk më kujtohet që kam thënë kështu, por edhe në atë  
11 kuptimin, mund të ndodhë që kemi dëgju, por unë them se nuk  
12 kam marrë pjesë në organizimin e tyre dhe nuk kam pas njohuri  
13 faktike dhe për diçka që nuk kam qenë vetë aty, unë nuk mund  
14 të, të jap, nuk mund të jap më shumë sqarime, sepse nuk kam  
15 qenë. Edhe nuk e kontestoj në atë kuptimin që kanë ekzistuar ato  
16 ose jo. Ndoshta kanë ekzistuar ato të organizuara, mirëpo unë në  
17 kohën për të cilën po flasim në atë kohë, kam qenë i zënë me  
18 organizimet e mia dhe nuk kam pas kohë që të di të tjerët ku  
19 kanë arrit me organizimin. Mund të ndodhë gjatë luftës ne e  
20 kemi dëgju.

21 PY. Në atë kohë, komunikoni ju me Fatmir Humollin?

22 PË. Po, komunikoni, normal. Po.

23 PY. A të ka thënë gjë ai ty për përpjekjet që po bënte për të  
24 krijuar struktura të UÇK-së në këto vende?

25 PË. Jo konkret diçka, por se po punohet, normal që po.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Tani mund të bëjmë pushimin, të  
2 nderuar Gjykatës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë një  
4 pushim të shkurtër, Dëshmitar, nja dhjetë minuta dhe do  
5 kthehemi përsëri. Ju lutem, mos flisni me askënd për dëshminë  
6 tuaj.

7 DËSHMITARI: Okej.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë  
10 minuta pushim.

11 --- Pauza fillon në orën 10.09

12 --- Seanca rifillon në orën 10.21

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
14 sillni dëshmitarin në sallë.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dua të bëj një sqarim lidhur me  
16 një nga provat materiale që u pranuan. Më tha kolegu që duhet  
17 të them për procesverbal që disa nga fotografitë në fakt duhet  
18 t'i bashkëngjiten një prove materiale ekzistuese. Është një  
19 provë që e ka marrë numrin përkatës. E kam fjalën për  
20 fotografitë që gjenden te materiali me numër SPOE00128386 deri  
21 në 00128420, të cilat janë fotografi që duhet t'i  
22 bashkëngjiten provës me numër P016148.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Ka kundërshtime?

25 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo.

- 1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
2 do të shtohen fotografitë te prova ekzistuese.
- 3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]
- 4 PY. Z. Dëshmitar, mirë se u kthyet. Më dëgjoni mirë?
- 5 PË. Po. Po, *thank you*.
- 6 PY. Jemi ende në të njëjtën faqe. E keni dokumentin përpara?
- 7 PË. Po.
- 8 PY. Në atë kohë, mars-prill të vitit 1999, u krijuan njësitet  
9 të UÇK-së në rajonin tuaj? Pra është Gollak?
- 10 PË. Po.
- 11 PY. Në këtë paragraf jepen disa emra. A e dini -- i njihni ju  
12 këta anëtarë të UÇK-së që përmenden te ky paragraf?
- 13 PË. Disa prej tyre.
- 14 PY. Kështu? nuk njihni?
- 15 PË. Ma mirë të them kë njoh. Me Rrahman Dinin kam  
16 bashkupunue, kam qenë bashkëpunëtor i afërt.
- 17 PY. Po Salih Mustafën?
- 18 PË. Po, e njoh?
- 19 PY. Brahim Mehmetajn? E njihni? Me "po" ose me "jo",  
20 domethënë, e njihni, apo s'e njihni.
- 21 PË. Në atë kohë nuk e kam njoft.
- 22 PY. Po a ka qenë ai ushtar i UÇK-së, e dini ju?
- 23 PË. E kam marrë vesh mbas lufte. Gjatë lufte nuk e kam  
24 takuar.
- 25 PY. Po Isa Kastrati?

- 1 PË. Po. E kam -- e kam njohur.
- 2 PY. Isuf Shalakun?
- 3 PË. Gjatë luftës nuk e kam njoft.
- 4 PY. Rahman Dinin?
- 5 PË. Po, e kam pas bashkëpunëtor të afërt.
- 6 PY. Flora Brovinën?
- 7 PË. E kam takuar, është kjo doktoresha, Flora Brovina.
- 8 PY. Shyhrete Gosalcin?
- 9 PË. Nuk e -- nuk më kujtohet që e kam taku atë gjatë luftës.
- 10 PY. Ramiz Abdullahun?
- 11 PË. Po.
- 12 PY. Haki Prebrezën?
- 13 PË. Nuk më kujtohet -- jo, nuk, nuk, nuk kam takuar.
- 14 PY. Hazir Borovcin?
- 15 PË. Jo.
- 16 PY. Gani --
- 17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z.
- 18 Michalczuk, bëni një pauzë përpara se të vijoni.
- 19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.
- 20 PY. Hazir Borovcin?
- 21 PË. Jo.
- 22 PY. Gani Sopin?
- 23 PË. Jo.
- 24 PY. Sabit Mushicën?
- 25 PË. Nuk e kam takuar.

- 1 PY. Fadil Fazliun?
- 2 PË. Nuk e kam takuar gjatë luftës ndonjëherë. Nuk më  
3 kujtohet. Ndoshta edhe e kam takuar, por e njoh si vëllain e  
4 dy dëshmorëve.
- 5 PY. Vëllai i kujt dëshmorëve? Çfarë emri kishin këta  
6 dëshmorët?
- 7 PË. Vëllai i Fahri dhe Bahri Fazliut.
- 8 PY. Sabit Krasniqin?
- 9 PË. Jo.
- 10 PY. Agron Ramën?
- 11 PË. Jo.
- 12 PY. Ejum -- Ejup Maqedoncin?
- 13 PË. Po. Bedri Gubetinin?
- 14 PY. Nuk e kam takuar.
- 15 PË. Po, a ka qenë anëtar i UÇK-së gjatë luftës? Keni dijeni?
- 16 PY. Nuk -- po, ka mësuar që ka qenë por nuk e kam takuar  
17 gjatë periudhës së luftës. Kam mësuar mbas luftës.
- 18 PË. Agron Xhemalajn?
- 19 PY. Po.
- 20 PË. Ismail Brahimin?
- 21 PY. Jo.
- 22 PË. Lulëzim Shabanin?
- 23 PY. Nuk e kam takuar, nuk e njoh.
- 24 PË. Kujtim Qerimin?
- 25 PY. Jo.

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 39

1 PË. Shemsi Kllokoqin?

2 PY. Jo.

3 PË. Besfort Demirin?

4 PY. Jo, jo.

5 PË. Gani Mustafën?

6 PY. Jo.

7 PË. Bahri Gashin?

8 PY. Jo.

9 PË. Z. Sopi, a e konfirmoni rolin e Fatmir Humollit në këtë  
10 periudhë kohore në zonën operative të Llapit?

11 PY. Po, është e vërtetë. Ka qenë.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj  
13 pranimin e kësaj faqeje si provë gjyqësore, e cila mund t'i  
14 bashkëngjitet provës që mban numrin P00187-ET, dhe shqipja me  
15 numrin P00187.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
17 kundërshtim?

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po, e kundërshtojmë. Dëshmitari  
19 nuk konfirmoi përmbajtjen e këtij paragrafi. Ai nuk e njeh  
20 shumicën e personave që përmenden këtu. Edhe nëse i njeh, ai  
21 nuk ka përmendur rolin që kanë pasur këta gjatë luftës, nëse  
22 kanë pasur ndonjë rol.

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Edhe ne në fakt i qëndrojmë të  
24 njëjtave parashtrimeve. Dëshmitari thjesht tha që njihte ose  
25 s'njihte disa prej personave. Por nuk ka njohuri për personat

1 kryesorë që përmenden në paragraf.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë gjë  
3 tjetër?

4 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

5 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] U bashkë -- bashkohemi  
6 parafolësve.

7 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Qëndrojmë - i  
9 mbajmë kundërshtimet. Gjithashtu, sa i takon relevancës, nuk  
10 mendojmë që ka asnjë relevant ky dokument, nuk e shikojmë pse  
11 duhet pranuar.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në rregull. Shkojmë në një faqe  
13 tjetër në të njëjtin dokument, me faqe SPOE0055848-ET, dhe  
14 shqipja me të njëjtin numër.

15 PY. Z. Sopi, e shihni dokumentet në ekran?

16 PË. Po.

17 PY. Edhe këtë e diskutuam gjatë seancës përgatitore. Të  
18 kujtohet?

19 PË. Po.

20 PY. Paragrafi në mes flet për periudhën tetor-nëntor të vitit  
21 1998, dhe flitet dhe për ju këtu, përmendet emri juaj. Tani,  
22 unë kam këtë pyetje: Njësitet e UÇK-së që u bënë më pas pjesë  
23 e Brigadës 153, a kishin qenë në atë kohë pjesë e Gollakut,  
24 siç përmendet këtu në këtë paragrafin që kemi përpara?

25 PË. Po, të gjitha njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës



1 që kanë të -- që kanë qenë në kuadër Brigadës 153, kanë qenë  
2 nga -- nga Gollaku.

3 PY. Përmenden disa persona këtu, për -- edhe ju aty, Salih  
4 Mustafa, Rrahman Dini. A luajtën ndonjë rol të rëndësishëm  
5 këta persona në organizimin e njësive të UÇK-së në atë  
6 rajon, siç thuhet në këtë paragraf?

7 PË. Po.

8 PY. Fill poshtë këtij paragrafi, është një paragraf tjetër që  
9 flet për disa takime që janë mbajtur në Prapashticë në mes të  
10 nëntorit të vitit 1998. A është mbajtur vërtetë një takim i  
11 tillë?

12 PË. Po, me kërkesën time, janë ftuar të gjithë përfaqësues të  
13 partive politike të asaj kohe, të gjitha organizatave që  
14 vepronin në rajonin tonë dhe përfaqësues të popullit, që ta  
15 kemi një takim dhe t'i njoftoj në lidhje me fillimin e --  
16 domethënë, në lidhje me organizimin e Ushtrisë Çlirimtare të  
17 Kosovës në Gollak. Në atë takim kanë marrë përfaqësues të --  
18 kanë marrë pjesë përfaqësues të Lidhjes Demokratike të  
19 Kosovës, dhe përfaqësues eventuale të partive të tjera, nuk më  
20 kujtohet a ka pas.

21 Po ashtu përfaqësues me ndikim të popullit, të cilët i  
22 kam njoftuar se ne jemi në organizim të njësive të Ushtrisë  
23 Çlirimtare të Kosovës, sepse në atë kohë Ushtria Çlirimtare e  
24 Kosovës nga njerëzit, nga populli ynë kërkohej sikurse i  
25 verbri që i kërkon sytë, dhe në atë takim kam marrë

1 mbështetjen e të gjithë të pranishmëve se do të jenë  
2 mbështetës dhe përkrahës të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të  
3 Kosovës. Aty kemi dalë të gjithë -- të gjithë me qëndrimin që  
4 Ushtria Çlirimtare e Kosovës në këtë rajon të masivizohet dhe  
5 kam -- kemi fituar përkrahjen e plotë të tyre, duke përfshirë  
6 furnizimin me të mira materiale, duke përfshirë edhe  
7 furnizimin me -- me persona të rinj, të cilët donin që t'i  
8 bashkoheshin Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

9 Dhe qëllimi ishte të hiqet çdo dilemë se a ekziston  
10 Ushtria Çlirimtare e Kosovës apo jo. Prandaj nga ky takim,  
11 edhe vetë unë kam dalë i kënaqur, dhe kemi vazhduar  
12 bashkëpunimin. Ka dalë të jetë shumë i frytshëm dhe punët na  
13 ka -- na kanë shkuar shumë mirë.

14 PY. Kush ka marrë pjesë në atë takim nga ana e UÇK-së?

15 PË. Takimin e kam thirr unë, ndërsa më kanë shoqëruar Fatmir  
16 Humolli dhe Rahman Dini.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj  
18 pranimin e këtij dokumenti dhe do të doja që t'i bashkëngjitet  
19 provës me numër P00187-ET dhe shqipja mban numrin P00187. [E  
20 pakuptueshme]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
22 kundërshtime?

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo.

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Jo.

25 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me  
2 numër SPOE00055848-ET në shqip dhe në anglisht pranohet dhe i  
3 -- do t'i bashkëngjitet provës me numër P00187.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund t'i heqim nga ekрани  
6 dokumentet. Më falni, jo, mos i hiqni nga ekрани, por shkojmë  
7 në një faqe tjetër. Ju kërkohet ndjesë. Shkojmë në faqen  
8 SPOE00055900. Të dyja dokumentet në këtë numër janë.

9 PY. Dëshmitar, i shihni dokumentet në ekran?

10 PË. Po.

11 PY. Këtë fletë e kemi diskutuar gjithashtu gjatë seancës  
12 përgatitore. Është një paragraf i cili është hartuar si një  
13 poshtëshënim që ka të bëjë me informacion që është marrë prej  
14 jush, z. Sopi. A mund të konfirmoni praninë ose ekzistencën e  
15 këtyre njësiveve periudhën e vitit 1999. Domethënë, në janar  
16 dhe në shkurt të vitit 1999, dhe emrat e komandantëve të tyre?

17 PË. Nuk i shoh.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të  
19 kalojmë në fund të faqes. Është te poshtë shënimi.

20 PY. E shikon tani?

21 PË. Po. Po, e shikoj.

22 PY. A konfirmoni që këto njësive vërtetë kanë ekzistuar dhe  
23 komandantët e njësiveve janë pikërisht këta persona të cilët  
24 jepen këtu? E konfirmoni këtë apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Po. Po.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të kalojmë te faqja tjetër.  
2 Vijohet më tej me listën me njësitet. Domethënë, vazhdojnë  
3 numrat e tjerë për njësitet.

4 PY. Z. Sopi, kjo është vazhdimi i listës. A konfirmoni  
5 ekzistencën e këtyre njësive dhe komandantët që kanë qenë  
6 komandantët përkatës i njësiveve ashtu siç shkruhet në këtë  
7 dokument?

8 PË. Po.

9 PY. Në rregull.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj në  
11 pranim prova, shfaqjen e parë, që për procesverbal është  
12 dokumenti SPOE 000559000, dhe faqja e njëjtë që përfundon me  
13 të. Kërkoj që të pranohen në prova gjyqësore, dhe gjithashtu  
14 kërkoj që të shtohet -- që të shtohen këto dy faqe, te prova  
15 P00187-ET, dhe në shqip 00187. Faqja tjetër është SPOE0055901-  
16 ET, është pranuar si pjesë e dëshmisë e një dëshmitari tjetër,  
17 dhe është pjesë e provave që unë përmenda më përpara.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
19 kundërshtim?

20 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes: Nuk kemi kundërshtim.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
22 SPOE0005900 në shqip dhe në anglisht pranohet dhe do të  
23 shtohet te prova P00187.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do ta bëjmë.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

1 PY. Dëshmitar, do e ndryshojmë pak temën. A ka pasur ndonjë  
2 qendër stërvitjeje të UÇK-së në Zllash gjatë luftës?

3 PË. Po.

4 PY. Në çfarë vendi e ka pas qendrën qendra e stërvitjes?

5 PË. Në shkollën e Zllashit.

6 PY. Nga e dini ju që ka qenë ky vendi? Shkollën e Zllashit,  
7 nga e dini, nga e njihni si vend?

8 PË. E njoh sepse aty jam -- kam -- jam lindur dhe jam rritur.

9 PY. A ke qenë i përfshirë në aspektin profesional në të  
10 shkollë përpara se të fillonte lufta, Dëshmitar?

11 PË. Po, tetë vite kam dhënë mësim në atë shkollë. Në kohën  
12 kur, kur pushteti serb i ka larguar të gjithë mësime dhënësit  
13 dhe i ka mbyllur të gjitha shkollat, unë jam paraqitur  
14 vullnetar dhe e kam çel shkollën e Zllashit dhe e kam dhënë  
15 mësim aty. Kam dhënë mësim për tetë vite, sa ka qenë shkollat  
16 tona të përjashtuara nga, nga sistemi arsimor i pushtesit  
17 serb.

18 PY. Atëherë, të flasim për qendrën e stërvitjeje në këtë  
19 shkollë. A mund të na thoni kur është krijuar kjo qendër?

20 PË. Koha e saktë nuk më kujtohet. Besoj në fillim të vitit  
21 1999.

22 PY. Dhe deri kur, deri kur ka funksionuar qendër stërvitjesh?

23 PË. Kjo qendër e stërvitjeje ka ekzistuar deri më 7 prill të  
24 vitit 1999, kur ka filluar ofensiva serbe nga drejtimi i  
25 Serbisë për në drejtim të pozicioneve tona.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të kalojmë edhe një herë te  
2 libri. I kërkoj falje Sekretares që nuk ua thashë këtë më  
3 përpara që e hoqët nga ekрани librin. Do kërkoj që të shohim  
4 shkurtimisht një faqe që është SPOE00055901 deri në  
5 SPOE00055902-ET. Kalojmë te faqja tjetër, nëse mundeni.

6 PY. E shikoni një faqe të librit përpara jush, Dëshmitar?  
7 PË. Po.

8 PY. A mund të na thoni çfarë është kjo ndërtesa që jepet te  
9 fotografia?

10 PË. Komunikata është ndërtesa e shkollës në Zllash.

11 PY. Është e njëjta shkollë në Zllash ku e ka pasur qendrën  
12 qendra stërvitore, siç na treguat pak më herët?

13 PË. Po, po.

14 PY. Sikurse mund ta lexoni poshtë fotografisë, është që  
15 trajnimet -- trajnuesit, pra, ishin Emin Borovci dhe Behxhet  
16 Vitia. A ka qenë kështu në fakt?

17 PË. Përgjegjës i kësaj qendre të trajnimit ka qenë Musli  
18 Halimi, ndërsa bashkëpunëtorët e tyre kanë qenë Emin Borovci  
19 dhe Behxhet Vitia, të cilët kanë bërë stërvitjen ushtarëve.

20 PY. E kuptoj. Faleminderit.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta heqim këtë fletën nga  
22 ekрани. Nuk është e nevojshme që të pranohen në prova sepse  
23 janë pranuar më përpara.

24 PY. Dëshmitar, në intervistën me ZPS-në, P01766.1, në faqet  
25 24 dhe 25, dhe në dëshminë përpara Trupit Gjykues, që ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 47

1 numrin P01767.1, në faqet 2035 e 2036, ju keni folur për  
2 krijim zyrtar të Brigadës 153. Në këto deklaratat kemi thënë që  
3 në shkurt të vitit 1999, zëvendës komandanti i zonës operative  
4 të Llapit, Kadri Kastrati, ka ardhur në Zllash dhe ka bërë të  
5 ditur vendimin e komandantit Mustafa për të krijuar Brigadën  
6 dhe për të bërë emërimet e caktuar lidhur me personat që do të  
7 drejtonin Brigadën? A është e vërtetë kjo?

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Është provë -- është pyetje  
9 orientuese. Në qoftë se do që të bëjë një pyetje Prokurori,  
10 duhet t'ia bëjë ndryshe, jo kështu.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares përsëri  
13 të na tregojë faqen e librit nga i njëjti libër që po  
14 diskutonim pak më parë. E ka numrin SPOE00055678 deri në  
15 SPOE00056018-ET. Faqja konkrete që dua është të paraqitet në  
16 ekran është SPOE00055911-ET. Në të njëjtin numër është edhe në  
17 shqip.

18 PY. Z. Sopi, e shikon këtë dokument në ekran?

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që e ndërpresim.  
20 Në qoftë se do të bëhet një pyetje orientuese, në qoftë se ti  
21 lexon një pjesë të librit, po ashtu është orientuese. Nuk  
22 është se ka ndonjë gjë të re këtu.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
24 kundërshtimi, ju lutem vazhdoni.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

1 PY. Z. Sopi, a e le -- a e shikoni këtë faqen e librit në  
2 ekran.

3 PË. Po.

4 PY. Në të flitet për ngjarjet që unë i ceka në pyetjen e  
5 mëparshme. A konfirmoni saktësinë e këtij paragrafi sa i takon  
6 këtij takimi?

7 PË. Po.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të  
9 paraqesë poshtëshënimet në këtë faqe.

10 PY. Dëshmitar, poshtëshënimi i fundit këtu thotë që personi  
11 që ka sugjeruar që brigada duhet që të drejtohet nga një  
12 oficer me përvojë, Agim -- Adem Shehu, ka qenë, domethënë, një  
13 propozim që ka ardhur prej jush. A është e vërtetë kjo?

14 PË. Po, e vërtetë. Kur kam dëgjuar unë për personin në fjalë,  
15 me vullnetin më të madh e kam pranuar që në vend timin, ai të  
16 jetë komandant i Brigadës 153, sepse kemi pas të bëjmë një  
17 oficer karriere, dhe do të ishte një, një, një vullnet më i  
18 madh i luftëtarëve që edhe nga Shqipëria janë vullnetarë të  
19 cilët po vijnë dhe po na ndihmojnë në luftën tonë çlirimtare.  
20 Ky ka qenë arsyeja që unë kam pranuar që Adem Shehu të jetë  
21 komandant i Brigadës 153.

22 PË. Më tepër ka qenë një akt moral, më tepër ka qenë ana  
23 morale edhe e luftëtarëve, që në krye të brigadës e kemi një  
24 oficer karriere.

25 PY. E kuptoj.



1           Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk është  
2 e nevojshme që të pranohet në provë gjyqësore ky dokument  
3 sepse është pjesë e një prove gjyqësore që është provuar -- që  
4 është pranuar më përpara, që është P00187-ET në shqip [Sipas  
5 përkthimit]. I kërkoj Sekretares të kalojmë te një tjetër faqe  
6 të të njëjtit dokument, që është SOPE00055912-ET, dhe të  
7 njëjtin dokument në shqip, që është e njëjta faqe, pa ET.

8 PY. A e shikoni dokumentet që keni përpara, z. Sopi?

9 PË. Po.

10 PY. Në këtë faqe flitet për brigadën që keni qenë komandant  
11 ju, një prej komandantëve. Domethënë, për Brigadën 153. Në një  
12 prej fjalive të para thuhet se në fillim fare, komanda e  
13 Brigadës 153 ka qenë në shtëpinë tuaj. A është e vërtetë kjo,  
14 Dëshmitar?

15 PË. Po, e vërtetë është. Brigada 153, komanda e saj për një  
16 kohë bukur të gjatë ka qenë në shtëpinë time.

17 PY. Jepet një listë, listë e njësive të ndryshme të  
18 Brigadës 153 dhe komandantët e tyre. A konfirmoni saktësinë e  
19 këtij paragrafi, domethënë sa i takon njësive dje  
20 komandantëve të tyre?

21 PË. Po të them të drejtën nuk e di sa mund të merret një  
22 libër si provë gjyqësore dhe si, si fakt. Po shoh shumë  
23 dokumente nga kjo libër, por në libra njerëzit kanë shkruar  
24 çka kanë dasht.

25 Po në rastin konkret, unë i shoh disa njësive dhe i shoh

1 disa emra, të cilët janë ashtu.

2 PY. Çfarë shenje thirrëse, çfarë kodi thirrës ka pasur  
3 Brigada 153 gjatë luftës?

4 PË. Brigada 153 gjatë luftës ka pas kodin thirrës Buna.

5 PY. Si caktoheshin këto kodet e komunikimit në njësite të  
6 ndryshme?

7 PË. Nuk e di si caktoheshin, por ka ishte kodi ynë.

8 PY. Mund të shohim që sa i takon emrave të njësiteve dhe  
9 vendeve ku kanë funksionuar ata, ka numra të ndryshëm, për  
10 shembull B26 për njësitin Rimanishte, ose B41 për njësitin e  
11 Ballabanit. A mund të na e shpjegoni, Dëshmitar, çfarë do me  
12 thënë, çfarë duan të thonë këto shifra edhe germa. Për  
13 shembull, B41-shi, B26-a? Na e shpjegon dot se çfarë duan të  
14 thonë ato?

15 PË. Shkronja -- germa Bashkëpunëtorë do të thotë Buna dhe  
16 njësiti, numri, është numri i njësitit, në mënyrë që të  
17 thirret në atë numër. Që mos të përmendet, për shembull,  
18 Rimanishtë por të përmendet B - Buna 26. Mos të përmendet, për  
19 shembull në komunikim Koliqi, për shkak të konfidencialitetit  
20 me -- karshi forca serbe, por të përmendet Buna 31. Kjo ishte  
21 arsyeja.

22 PY. E kuptoj.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që  
24 në -- që këtë faqe të mund ta pranojmë në prova dhe të shtohet  
25 te një provë gjyqësore ekzistuese, që është P00187.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
2 kundërshtime?

3 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes: Nuk kemi kundërshtime.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
5 SPOE0055912 në anglisht dhe në shqip, pranohet në provë  
6 gjyqësore dhe do t'i shtohet provës ekzistuese P00187.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do ta shtojmë, të  
8 nderuar Gjykatës.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

10 PY. Z. Sopi, do ndryshojmë pak temën. Brigada 153, a ka pasur  
11 njësite ose persona që kanë qenë përgjegjës për komunikimin në  
12 mënyrë të drejtpërdrejtë me median. Për shembull, me  
13 KosovaPress-in?

14 PË. Jo nuk ka pasur persona të caktuar për tak -- për kontakt  
15 me mediat. Jo.

16 PY. Në rast se, të themi, që ka pasur një zhvillim në luftë  
17 në -- një zhvillim të caktuar ose një betejë të caktuar, kush  
18 i raportonte shtypit sai takon këtij zhvillimi në një betejë  
19 të caktuar? Në qoftë se nuk ka enë, për shembull, Brigada 153,  
20 kush tjetër mund t'i ketë raportuar shtypit lidhur me këtë?

21 PË. Nuk e di. Në kuadër të Brigadës nuk kemi pas ndonjë  
22 sistem informimi. Normal që do të komunikonte me mediat sepse  
23 -- edhe nuk kemi pas kontakt me media kurrë.

24 PY. Brigada 153 në varësinë e kujt ishte gjatë luftës.

25 PË. Gjatë luftës ishte nën varësinë e zonës operative të

1 Llapit.

2 PY. Pra, në qoftë se do ekzistonte nevoja që të raportohet  
3 sa i takon zhvillimeve në fushën e betejës, a i takon që do  
4 ishte zona operative e Llapit ajo që do kontaktonte me median?

5 PË. Po. Sigurisht, po. Po.

6 PY. Z. Sopi, mbrojtja civile, ose struktura e mbrojtjes  
7 civile a kanë funksionuar në zonën operative të Llapit gjatë  
8 luftës?

9 PË. Në zonën ku kam vepruar unë nuk kemi mujt të organizojmë  
10 ndonjë farë mbrojtje civile, sepse menjëherë kemi kaluar në  
11 operacione lufte dhe nuk kemi pas hapësirë që të -- që të  
12 merremi me organizimin e mbrojtjes civile. I vetmi organizim,  
13 domethënë që ka luajtur rolin e mbrojtjes civile dhe  
14 furnizimin e Brigadës 153, ka qenë -- ka qenë logjistika,  
15 sistemi logjistik, në krye të së cilës ka qenë heroi Ismet  
16 Asllani.

17 PY. Nuk ishte pyetja ime kjo. Nuk kishte të bënte konkretisht  
18 me brigadën tuaj. Pyetja ime kishte të bënte me strukturat e  
19 mbrojtjes civile që funksiononin në zonën operative të Llapit.  
20 Pra, në nivelin e zonës operative të Llapit. A keni qenë në  
21 dijeni të strukturave të tilla, Dëshmitar?

22 PË. Unë kam dëgju, por nuk kam qenë në dijeni. Nuk kam -- nuk  
23 kam pas dhe qasje në sistemin e organizimit të tyre.

24 PY. A e dini emrin e personit që ka qenë drejtuesi i  
25 mbrojtjes civile në zonën operative të Llapit, Dëshmitar?

1 PË. Me të thënë të drejtën, e kam -- e kam mësuar mbas  
2 luftës, por që për momentin më ka ikur emri i tij. E di kush  
3 ka qenë, po për momentin s'më kujtohet.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, të  
5 nderuar Gjykatës, dua që të rifreskoj memorien, kujtesën  
6 dëshmitarit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund ta  
8 bëni. Vazhdoni.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

10 PY. Do t'ju lexoj një pjesë të seancës përgatitore, të  
11 Shënimit Përgatitor 2, paragrafin 19. Unë ju tregova të  
12 njëjtën faqe të këtij dokumenti. Ju konfirmuat faktin që  
13 strukturat e mbrojtjes civile kanë ekzistuar në nivelin e  
14 zonës operative të Llapit dhe drejtuesi i mbrojtjes civile ka  
15 qenë Muhamet Latifi për zonën e Llapit. A e konfirmoni që  
16 është kështu, Dëshmitar?

17 PË. Po, e vërtetë. Nuk m'u kujtojke.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga  
19 ekрани, dhe në vend të tij dua që të paraqisni një fotografi  
20 me numër SPOE00222559 deri në 00222559.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, kjo  
22 është një fotografi e cila është pranuar në prova gjyqësore  
23 dhe ka numrin P01685.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në rregull.

25 PY. Z. Sopi, a e shikoni këtë fotografi që kemi përpara në

1 ekran?

2 PË. Po.

3 PY. A e njihni ndonjë person në këtë fotografi?

4 PË. Po.

5 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykses se kështu? njihni?

6 PË. Në këtë foto, ulur, jam unë, pranë meje është Salih

7 Mustafa. Në këmbë, sipër meje aty është Agron Xhemajli, ndërsa

8 personin tjetër nuk më kujtohet. Nuk, nuk e di kush është. Nuk

9 më kujtohet.

10 PY. Pra, Agron Xhemajli është personi që është pas jush, këtë

11 po thoni? Qëndron pas jush?

12 PË. Po, po. Pas meje?

13 PY. Ku është bërë kjo fotografi?

14 PË. Me siguri në periudhë të luftës, në Zllash [e

15 pakuptueshme].

16 PY. Thatë gjatë luftës --

17 PË. Po.

18 PY. A mund të na e thuash më konkretisht se në çfarë periudhe

19 pak a shumë është bërë fotografia?

20 PË. Jo, nuk mund -- nuk -- e kam harru. Të njëjtën fotografi

21 po më duket sikur që i ka shkrep dikush tjetër -- edhe në

22 fotografinë tjetër që ke, mirëpo nuk më kujtohet as kush e ka

23 shkrep edhe nuk e kam poseduar kurrë këtë foton.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë

25 se më lejoni, dua që t'i rifreskoj kujtesën dëshmitarit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
2 vazhdoni.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, ju thatë gjatë seancës përgatitore, dhe kjo  
5 pasqyrohet në Shënimin Përgatitor 2, paragrafi 26, si më  
6 poshtë. Kur ju tregova këtë fotografi, ju thatë - ju  
7 identifikuat veten, Salih Mustafën, Agron Xhemajlin, pas teje,  
8 dhe thatë që:

9 "Fotografia është bërë në Zllash. Jo në shkollë dhe as në  
10 shtëpinë time. Në fund të vitit 1998, ose fillim të vitit  
11 1999."

12 A e konfirmoni periudhën e kohës kur është fotografia që  
13 keni përpara në ekran, Dëshmitar?

14 PË. Po, afërsisht në atë periudhë. Në periudhë të luftës  
15 është. Po.

16 PY. Faleminderit.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta hiqni fotografimin nga  
18 ekрани. Ndërkohë do ju kërkoja që të paraqisni dokumentin, ose  
19 fotografinë e fundit që ka numër SPOE00222687-000222687 [Sipas  
20 përkthimit].

21 PY. A e shikoni një fotografi në ekranin që keni përpara,  
22 Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. A njihni ndonjë person në këtë fotografi?

25 PË. E njoh disa persona në këtë foto.

1 PY. A mund të na thoni, kështu? njihni?

2 PË. E njoh bashkëluftëtarin tim -- Salih Mustafa është ky me  
3 uniformë. E njoh --

4 PY. Ku është ai, mund të na e thoni? Na e përshkruani pak më  
5 mirë, në çfarë pozicion, në çfarë vendi është në fotografi?

6 PË. E para.

7 PY. Është ai që ka këtë kapelën e kuqe?

8 PË. Po.

9 PY. -- dhe syze dielli?

10 PË. Po.

11 PY. Kë tjetër njihni në të këtë fotografi ,në qoftë se njihni  
12 dikë tjetër?

13 PË. Prapa tij e shoh të nderuarin presidentin tonë, heroin e  
14 gjallë, Hashim Thaçin, dhe krahu tij e shoh komandantin tonë të  
15 respektuar, Rustem Mustafën.

16 PY. Z. Thaçi është ai që ka kravatë?

17 PË. Po.

18 PY. Po Rustem Mustafa është ai që po ecën ngjitur me të,  
19 përbri tij, që ka këtë uniformën lara-lara?

20 PË. Po, përkrahu tij, është me uniformë.

21 PY. Kur është bërë kjo fotografi?

22 PË. Nuk kam njohuri. Për herë të parë e kam parë në seancën  
23 përgatitore, kur ma keni treguar ju.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, të  
25 nderuar Gjykatës, dua t'i rifreskoj kujtesën dëshmitarit.



Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 57

1 është pyetja e fundit, para se të bëjmë pushimin.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

4 PY. Gjatë seancës përgatitore ju treguam këtë fotografi. Në  
5 paragrafin 24 të para -- të Shënimit Përgatitor numër 2, ju  
6 thatë që "konfirmoj që kjo fotografi është bërë pak kohë pas  
7 luftës". A e konfirmoni këtë, Dëshmitar?

8 PË. Ashtu më duket, po.

9 PY. Faleminderit.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam  
11 pyetje të tjera për dëshmitarin.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

13 Dëshmitar, kemi pushim për gjysmë ore. Mund të largoheni  
14 nga salla e gjyqit bashkë me asistenten. Ju lutem mos flisni  
15 me askënd lidhur me dëshminë tuaj përpara Trupit Gjykses dhe  
16 do të takohemi përsëri për 30 minuta.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
19 pushim deri në orën 11.30.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

21 --- Pauza fillon në orën 11.02

22 --- Seanca rifillon në orën 11.30

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z.

24 Michalczuk.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Përpara se të vijë dëshmitari

1 më kujtuan kolegët që fotografia e fundit që i tregova  
2 dëshmitarit nuk ka numër të provës materiale.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ti nuk  
4 kërrove fare që të pranohej fotografia.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, nuk e kërrova, prandaj po e  
6 kërkoj tani.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
8 kundërshtime?

9 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po, e kundërshtojmë sepse kemi  
10 pikëpyetje për relevancën dhe vlerën provuese të kësaj  
11 fotografie, sepse dëshmitari nuk na dha dot as datë as  
12 vendndodhje dhe as në ç'mënyrë është marrë kjo fotografi.

13 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] I bashkohemi parafolëses.

14 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi gjë tjetër për të shtuar.

15 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi gjë tjetër për të  
16 shtuar.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 [Përkthim] Është relevante fotografi dhe do të pranohet.

19 Materiali me numër SPOE00222687 deri në 00222687 pranohet  
20 dhe do të marrë numrin përkatëse.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë  
22 numrin P01774 dhe ju lutem më thoni klasifikimin.

23 Z. MICHALCZUK: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 [Përkthim] Riklasifikojeni si dokument publik.

1 Znj. Menegon, fjala është për ju për kundërpjetjet.

2 Po fillimisht të sjellin dëshmitarin. Ju lutem sillni  
3 dëshmitarin në sallë.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
6 Dëshmitar. Do vazhdojmë tani. Mbrojtja e Thaçit i ka pyetjet  
7 tani. Janë në të djathtën tuaj. Ju lutem dëgjojini me  
8 vëmendje. dëgjojini me vëmendje.

9 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

10 Pyetje të palës tjetër nga znj. Menegon:

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

12 PY. Z. Dëshmitar, unë quhem Sophie Menegon, dhe do t'ju bëj  
13 disa pyetje në emër të z. Thaçi.

14 Dëshmitar, a e kam kuptuar unë drejt nga dëshmia jua që  
15 është pranuar përmes rregullës 154 se ju mendonit se UÇK-ja ka  
16 qenë një grup vullnetar, spontan që u krijua për t'u  
17 përgjigjur krimeve që po kryenin forcat serbe?

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund të na jepni referencën?

19 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo, është pyetje e hapur.

20 PY. Duke marrë parasysh që UÇK-ja ishte një ushtri vullnetare  
21 është diçka që është përmendur në provën P1766.1, faqja 1, ju  
22 keni thënë në atë kohë që UÇK-ja është sulmuar disa herë prej  
23 forcave serbe veçanërisht në prill 1999. Pra, e kam kuptuar  
24 unë saktë që sipas jush UÇK-ja ishte një grup vullnetarësh që  
25 u krijua për t'u kundërpërgjigjur krimeve nga forcat serbe?

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është pyetje e përbërë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
3 bëjeni më thjesht pyetjen.

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

5 PY. Z. Dëshmitar, sipas jush UÇK-ja a ishte një ushtri  
6 vullnetare?

7 PË. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një ushtri vullnetare.  
8 Burimin e kishte në popull dhe ishte si rezultat i vuajtjeve  
9 shekullore të popullit tonë nën robëri. Dhe Ushtria Çlirimtare  
10 e Kosovës është projekti më i madh i shqiptarëve pas shpalljes  
11 së pavarësisë së Shqipërisë, e cila në luftën e saj të drejtë  
12 çlirimtarë fitoi përkrahjen e të gjithë botës demokratike, të  
13 popullit tonë, duke filluar edhe botës demokratike, duke  
14 filluar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e  
15 Bashkuar, si dhe shtetet e Bashkimit Evropian. Me luftën e saj  
16 të drejtë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës bëri të mundur  
17 çlirimin e vendit tonë, bashkë me --

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
19 Dëshmitar, ju lutem me "po" ose me "jo" përgjigjen.

20 DËSHMITARI: Po.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E morëm tani  
22 që ju thatë po, kështu e kuptuam.

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

24 PY. Pra, e kuptoj unë drejt që është krijuar thjesht për t'u  
25 përgjigjur ofensiva dhe krimeve që po kryenin forcat serbe

1 kundër popullsisë shqiptare?

2 PË. E saktë.

3 PY. Faleminderit. Në zonën tuaj, UÇK-ja filloi të organizohej  
4 më mirë dikund nga fundi i janarit '99, fillimi i shkurtit '99  
5 me krijimin e Brigadës 153 në Zllash, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Në fillim, pra, që nga '98 ju nuk kishit armë, apo jo, në  
8 fillimet e vet?

9 PË. Në fillimet tona nuk kemi pas armë, por kemi bërë  
10 organizimin e njerëzve dhe përgatitjen e tyre për t'ju  
11 përgjigjur ofensivave dhe betejave të mundshme nga agresori  
12 serb.

13 PY. Faleminderit. Ju filluat të merrnit disa armë më pas kur  
14 vetë personat që po kyçeshin në UÇK vinin me armët e tyre,  
15 kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Pra, fillimisht nuk është se kishit ndonjë zinxhir  
18 furnizimi për armët, nuk ju furnizonte njeri me armë, apo jo?

19 PË. Jo, nuk kemi pas, vetëm armët që kanë qenë në posedim nga  
20 populli dhe si kriter për bashkangjitjen në radhët e Ushtrisë  
21 Çlirimtare të Kosovës ne kemi pasur ata njerëz që janë të  
22 përshkuar për luftë dhe që kanë mundësisht armatimin e vet ose  
23 mund ta sigurojnë dikah vetë.

24 PY. Faleminderit. Para krijimit të Brigadës 153 - e kam  
25 fjalën në fakt po mbështetem në intervistën që keni dhënë për

1 Prokurorinë me numër P1766.5, faqja 15 - këtu keni thënë që ju  
2 nuk keni marrë ndonjë urdhëresë ushtarake prej komandantit të  
3 zonës së Llapit, kështu?

4 PË. Ne zakonisht ju kemi referuar, domethënë, situatave që  
5 kemi ndodh, nuk kemi pas nevojë që të marrim ose urdhra ose  
6 këshilla nga dikush.

7 PY. Ju thatë, në fakt, që ka pasur një qendër stërvitore në  
8 Zllash rreth shkurtit '99. A është e vërtetë që fillimisht  
9 ishte shumë bazike kjo qendër, sidomos për shembull vetë  
10 trajnerët nuk e dinin kush do merrte pjesë në ato stërvitje që  
11 bëheshin, kështu?

12 PË. Ashtu është. Ajo qendër u formu si nevojë sepse në radhët  
13 tona filluan të vijnë djem të ri të cilët nuk kishin ndonjë  
14 përvojë ushtarake dhe për t'i ruajtur nga ndonjë aksident,  
15 vetëaksident me armë dhe për t'i përgatitur për betejat e  
16 ardhshme, ne e ndërmorëm masat që të organizojmë trajnimin  
17 bazik të tyre dhe elementar për përdorimin e armëve dhe  
18 njohuritë elementare për luftë.

19 PY. Faleminderit. Ju po ashtu thatë se nuk u bëhej ndonjë  
20 kontroll i qenësishëm këtyre rekrutëve që të parandalonit  
21 infiltruesit. Për shembull, ju thatë që nuk e dinit fare a i  
22 përkisnin a s'i përkisnin LDK-së disa prej tyre.

23 PË. Jo, këta kanë ardhë me mënyrë të organizuar nga njësitet  
24 tona që i kemi pas në fshatra dhe, për shembull, një fshat e  
25 ka pru njësitin e tij dhe verifikimi dhe të gjitha ato i kanë

1 bërë domethënë komandantët e njërive atje në vendin e tyre.

2 Ndërsa në Zllash kanë ardhë ata, nuk kemi pas nevojë që t'i  
3 identifikojmë.

4 PY. E kuptova. Pra, siç e kuptova unë, anëtarët e UÇK-së mund  
5 të kyçeshin në UÇK edhe gjithashtu edhe ish-oficerët e armatës  
6 jugosllave mund të ishin pjesë e radhëve të UÇK-së, kështu?

7 PË. Po, e vërtetë, edhe kemi pas në radhët tona.

8 PY. Mund të na thoni ndonjë emër, për shembull?

9 PË. Kemi pas shefin e shtabit të zonës, Nuredin Ibishin. Kemi  
10 pas Idriz Shabanin, komandantin e Brigadës 151, ish-oficerë të  
11 ushtrisë jugosllave. Ndërsa njëri ka qenë zyrtar policor,  
12 Nuredin Ibishi.

13 PY. Faleminderit. Pasi trajnimit, rekrutët -- rekrutëve të  
14 rinj nuk i jepesh uniforma apo armë, kështu?

15 PË. Jo, nuk kemi pushim mundësi.

16 PY. Pra, ju nuk kishit mjetet bazike që t'i furnizonit, apo  
17 t'ua jepnit apo t'ua jepnit personave, kështu?

18 PË. Nuk kishim në atë kohë, jo.

19 PY. A është e vërtetë që personat mund t'i blinin vetë  
20 uniformat në rrugë po të donin? E bënë në fakt?

21 PË. Po, kanë mundun edhe t'i blejnë vetë, kanë mundun. Mirëpo  
22 një pjesë e njerëzve tonë nuk kanë pasur uniforma kurrë, por e  
23 kanë zemrën dhe qëllimin që të luftojnë për liri.

24 PY. Në fakt prandaj dhe brenda UÇK-së uniformat nuk ishin  
25 njësoj, dhe madje disa ishin thjesht me veshje me tesha civile

1 apo jo?

2 PË. E vërtetë.

3 PY. Kështu që mund të ndodhte që disa mbanin uniforma të UÇK-  
4 së, por që s'ishin fare anëtarë të UÇK-së, ndodhte edhe  
5 kështu, apo jo?

6 PË. Ka mund të ndodhë edhe ajo, mirë po ne nuk kemi -- në  
7 terren ku kam vepru unë, nuk kam informacione të tilla.

8 PY. Faleminderit. Sa i takon strukturave të UÇK-së kur u vra  
9 Adem Shehu, komandanti i Brigadës 153, ju i thatë Prokurorisë  
10 - në provën P1766.2, faqja 2 - pra, i keni thënë që prej Adem  
11 Shehut nuk është se kishit marrë ndonjëherë ndonjë urdhër me  
12 shkrim, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe ju i keni thënë Prokurorisë - në provën 1766.2, në  
15 faqen 4 - se ju nuk e konsideronit atë komandant ushtarak në  
16 kuptimin e mirëfilltë të fjalës, sepse UÇK-ja ishte një ushtri  
17 vullnetare. Pra, e keni fjalën ju që personat u bindeshin  
18 urdhrave thjesht sepse i respektonin këto urdhrat apo  
19 pajtoheshin me urdhrat?

20 PË. Normal, sepse Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka mundur  
21 që të ketë rregull dhe disiplinë sikur sot që kanë, për  
22 shembull, ushtritë e NATO-s, sepse ajo është bazuar në  
23 gjendjen e saj se është vullnetare dhe ushtarët që iu kanë  
24 bashkangjitur asaj janë plotësisht me vullnetin e tyre dhe pa  
25 asnjë presion nga askush.



1 PY. Faleminderit. Sa i takon krijimit të Brigadës 153, keni  
2 thënë më 18 janar 2022 - dhe po referohem në provën 1767.1,  
3 faqja 2034-2035 - se fillimi i kësaj brigade ka nisur me  
4 njësitet që ishin krijuar thujse në çdo fshat në Gollak, në  
5 zonën e Gollakut, dhe u bë zyrtar në shkurt 1999 kur pati  
6 numër të mjaftueshëm ushtarësh dhe se Kadri Kastrati e ka  
7 inauguruar këtë brigadë.

8 Pra, a është Kadri Kastrati personi që në një farë mënyre  
9 e bëri zyrtare këtë strukturë që e kishit krijuar ju?

10 PË. Po, e vërtetë.

11 PY. Faleminderit. Në provën P1766.1, në faqen 2036, ju keni  
12 thënë që:

13 "Meqë merreshit me organizimin e UÇK-së në terren, dhe  
14 meqë ishit gjatë të gjithë kohës në terren, sidomos në zonat,  
15 në zonën e fshatit të Gollakut më caktuan përgjegjës për  
16 mbrojtjen civile."

17 Pra, a mund të themi që ju u emëruat si person përgjegjës  
18 për mbrojtjen civile ishte në një farë mënyre ishte një  
19 shpërblim për punën që ju kishit bërë më përpara?

20 PË. Po jo unë isha organizatori, njëri ndër organizatorët  
21 kryesorë bashkë me shokët e mi dhe nuk ishte ajo çështje  
22 shpërblimi sepse unë fillimisht mora propozimin që të  
23 emërohesha komandant i brigadës. Mirëpo meqë kishim njohuri se  
24 një oficer i karrierës do të vinte në rajonin tonë, pranova  
25 që, dhe me vullnetin ma të madh, pranova që Adem Shehu të vijë

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Menegon

Faqe 66

1 komandant brigade, sepse shpërblimi, për shembull, aty çështja  
2 e shpërblimeve. Unë, shpërblimi im ma i madh ishte që isha në  
3 shërbim të luftës dhe në shërbim të kombit tim.

4 PY. E kuptoj, e kuptoj, po unë doja të thoja thjesht këtë: Ju  
5 nuk pritët që ta zyrtarizonte vetë komanda e Llapit. Ju kishit  
6 filluar punën në zonën tuaj dhe në shkurt '99 kjo u bë  
7 zyrtare, por ju ndërkohë e kishit marrë përsipër iniciativën  
8 që të krijonit njësitin?

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po duket sikur avokatja po bën  
10 vetë dëshminë tani.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

12 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, a mund t'i përgjigjeni? Po ç'a t'i përgje --

14 DËSHMITARI: Jo, unë e kam thënë edhe gjithherë edhe thom  
15 prapë, ne njësitet tona dhe organizimin tonë e kemi kry, e  
16 kemi organizu përpara se të shtrihej organizimi në zonën tonë,  
17 domethënë, ne kishim marrë masa edhe përpara se të merrnim  
18 lidhje me strukturën organizative të Ushtrisë Çlirimtare të  
19 Kosovës. Njësitet tona janë formuar edhe më herët sepse ne  
20 vetëm e pritshim kontaktin e parë me Ushtrinë Çlirimtare të  
21 Kosovës. Domethënë, ne, njësitet tona në Gollak ju kanë  
22 parapri, ju kanë parapri shtrirjes organizative të Ushtrisë  
23 Çlirimtare të Kosovës te ne.

24 PY. Po ashtu, përpara krijimit të Brigadës 153, Rahman Dini  
25 po punonte bashkë me ju të krijonit radhët e UÇK-së në fshatin

1 e Gollakut, kështu? Në fshatrat e Gollakut, kështu?

2 PË. E saktë, po.

3 PY. Pra, kur u emërua si pjesë e shtabit të Brigadës 153, në  
4 thelb kjo ishte thjesht një konfirmim i përfshirjes apo punës  
5 që ai kishte bërë tashmë në -- me UÇK-në në atë zonë, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Në Shënimin Përgatitor numër 2, paragrafi 19, ju keni  
8 thënë se shefi i Mbrojtjes civile për Llapin, ishte Muhamet  
9 Latifi dhe keni shtuar se nuk keni marrë asnjë urdhër prej  
10 tij. E konfirmoni këtë?

11 PË. E konfirmoj. E vërtetë.

12 PY. Faleminderit. Pra UÇK-ja në zonën tuaj kishte marrëdhënie  
13 të mira me LDK-në asokohe, kështu?

14 PË. Marrëdhënie të shkëlqyeshme.

15 PY. Keni thënë që vëllai juaj, Demiri, ka qenë përfaqësues i  
16 LDK-së për Zllashin në atë kohë, kështu?

17 PË. Po, edhe njëkohësisht anëtar, pjesëtar i Ushtrisë  
18 Çlirimtare të Kosovës.

19 PY. A mund të na përshkruani rolin e tij në LDK dhe në UÇK në  
20 atë kohë?

21 PË. Roli i tij në LDK ka qenë si përfaqësues i fshatit, në  
22 kuadër të degës së LDK-së për Gollak. Ndërsa në radhët e  
23 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë ushtar i Ushtrisë  
24 Çlirimtare të Kosovës deri përfundimin e luftës.

25 PY. UÇK-ja dhe LDK-ja bashkëpunonin për çështje praktike, si

1 për shembull çështjet e ushqimit apo si të mbronin apo t'i

2 ofronin kujdes shëndetësor njerëzve në zonën tuaj?

3 PË. Krejt ai organizimi i LDK-së që ka qenë në zonën e

4 Gollakut të gjithë, i gjithi është vu në shërbim të Ushtrisë

5 Çlirimtare të Kosovës dhe kemi pas përfaqësues të atyne

6 grupeve edhe komandantë të batalioneve dhe të njësive të

7 ndryshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe bashkëpunimi ka

8 qenë i mirëfilltë pa asnjë incident.

9 PY. Ju thatë që keni pasur komandantë të UÇK-së që në fakt në

10 zonën tuaj ishin anëtarë të LDK-së. A mund të na jepni ndonjë

11 emër?

12 PË. Po. Ejup Gashi, përgjegjës për -- komandant për rajonin e

13 Mramorit ka qenë pjesë dhe është pjesë e LDK-së, ndërsa ka

14 qenë komandant batalioni. Ka qenë Shefki Gashi, ka pas plot

15 anëtarë të tjerë, komandantë të njësive të tjera që kanë qenë

16 pjesë e LDK-së dhe që iu kanë bashkangjitur me vullnetin e

17 tyre Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri në përfundimin e

18 luftës dhe nuk kanë kursy asgjë që kjo luftë të ketë sukses.

19 PY. Faleminderit. Në veçanti, UÇK-ja dhe LDK-ja kanë

20 bashkëpunuar për evakuimin e civilëve në prill '99 në vijim të

21 ofensivave prej serbëve?

22 PË. Po, gjithsesi, po. Ajo strukturë e LDK-së është marrë ma

23 tepër se -- i ka njoft edhe njerëzit, i kanë pas edhe

24 organizimin e tyre në kuadër të kësaj një shoqate bamirëse,

25 Nëna Terezë, kanë pas edhe rezerva ushqimore kanë siguri

1 gjithçka për popullatën civile dhe i kanë organizu ato punë  
2 për mrekulli. Dhe na e kanë lehtësu neve punën tonë që të na  
3 ndihmojnë në mirëqenin e asaj popullate civile e cila ka qenë  
4 e përzënë nga Prishtina dhe Podujeva dhe rrethinat e tyre.

5 PY. Faleminderit. Po ju vetë keni qenë anëtar i LDK-së?

6 PË. Jo.

7 PY. Faleminderit. Nuk kam më pyetje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Znj. Rowan.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully.

12 Pyetje të palës tjetër nga z. Tully:

13 Z. TULLY: [Përkthim]

14 PY. Mirëdita ose mirëmëngjes, Dëshmitar. Unë quhem Eric Tully  
15 dhe përfaqësoj Rexhep Selimin. Kam disa pyetje për ju.

16 Znj. Menegon ju bëri pyetje për vëllain tuaj që ka qenë  
17 në LDK. Po ju thatë po ashtu që ai ka qenë anëtar i UÇK-së  
18 deri në fund të luftës. Tani pyetja është kjo: Sa kohë ka qenë  
19 ai përfaqësues i LDK-së për Zllashin, dhe në cilat vite?

20 PË. Ka qenë shumë ma përpara sesa lufta dhe deri në  
21 përfundim. Domethënë, deri kur ka përfundu lufta. Gjithë ka  
22 qenë pjesë e LDK-së edhe ma herët.

23 PY. Pra, ka qenë përfaqësues i LDK-së gjatë kohës që ju jeni  
24 ngritur në detyrë në UÇK, kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Kam një aspekt tjetër që mbase mund të më ndihmoni. Nëse  
2 s'keni gjë për të më thënë, nuk ka problem. Sot Prokuroria ju  
3 bëri një pyetje në faqen 22 deri në 25 të transkriptit të  
4 ditës së sotëm. Ju pyeti për kontaktet që kishte zona e  
5 Llapit, Zllashi në veçanti dhe -- pra, kontakti që kishte zona  
6 e Llapit me anëtarët e UÇK-së nga Karadaku. Ju kujtohen këto  
7 pyetje që ju bëri Prokurori sot?

8 PË. Domethënë zona e Llapit me zonën e Karadakut, po.

9 PY. Po, po. Po. Bashkëpunuan, për shembull, për luftimet në  
10 kuadër të brigadës 153, ju bëri disa pyetje nëse këto luftime  
11 dhe disa nga zona e Karadakut? Ju kujtohen këto pyetje?

12 PË. Ata përfaqësues të zonës Karadakut vendqëndrimin e kanë  
13 pas te ne. Dhe në momentin kur ka shpërthyer ofensiva serbe e  
14 18 prillit ata janë vu në mbrojtje të popullatës civile dhe të  
15 njërive të tyre. Kjo është.

16 PY. Thjesht për t'ju orientuar ishte kjo. A e njihni një  
17 person me emrin Selami Neziri? E keni vëllazni mbase? Sulejman  
18 Neziri, Sulejman Neziri.

19 PË. Jo, nuk e njoh.

20 PY. Mbase e njihni me emrin tjetër, Agron. A e njihni një  
21 person nga zona e Karadakut që kishte emrin Agron?

22 PË. Kam harru. Mund të ndodhë që -- nuk më kujton. Nuk më  
23 kujtohet për momentin. Nuk më kujtohet për momentin. Agron.

24 PY. Po, po, si emër i dytë. Domethënë, Sylami, ose Selami  
25 Neziri.

1 PËRKTHYESJA: Përkthyesi nuk e kupton të qartë emrin.

2 Z. TULLY: [Përkthim]

3 PY. Me emër të dytë, Agron. Atëherë në rregull.

4 Z. TULLY: [Përkthim] Vendosim në ekran dokumentin

5 SIT00265580 deri në 00265581, është faqja 00265581,

6 konkretisht. Do tua lexoj. Nuk është e rëndësishme përmbajtja

7 këtu, po kjo është një peticion kundër shefit të arsimit,

8 kulturës dhe sporteve që është nisur këtu nga komandanti i

9 UÇK-së, z. Selami Neziri. Për këtë person e keni fjalën, apo

10 jo ose ndryshe Agron. Pra, Selami Neziri nga Vitnia, ju

11 kujtohet, ka qenë nga Vitnia -- Vitina?

12 PË. Nuk e kam dit ka është ai, nuk e kam dit.

13 PY. Në rregull. Faleminderit.

14 Z. TULLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sa i takon

15 relevancës më intereson kjo pjesë të pranohet sepse dua ta

16 përdor me disa dëshmitarë të tjerë që janë për të ardhur këtu

17 në sallën e gjyqit. Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 Pyetje të palës tjetër nga znj. S. Alagendra:

20 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

21 PY. Mirëdita z. Dëshmitar. Unë quhem Shyamala Alagendra, dhe

22 përfaqësoj z. Jakup Krasniqi. Kam disa pyetje dhe unë.

23 Pyetja ime e parë po ashtu lidhet me çështjen e LDK-së. A

24 kam të drejtë unë kur them që një pjesë e madhe të anëtarë të

25 UÇK-së në rajonin tuaj ishin po ashtu aktivistë, veprimtarë të

1 LDK-së?

2 PË. Po, e vërtetë është.

3 PY. Gjatë luftës mesa dini ju, ka pasur ndonjë politikë UÇK-  
4 ja që ata që ishin në LDK të konsideronte kundërshtarë të UÇK-  
5 së?

6 PË. Në regjionin ku kam vepruar unë nuk ka pas asnjë përçarje  
7 politike dhe nuk ka pas asnjë politikë përpos luftës  
8 veprimtare. Dhe nuk ka pasur asnjë mosmarrëveshje në mes të  
9 radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të gjithë e kanë  
10 pas për parti dhe për politikë luftën e drejtë çlirimtare dhe  
11 çlirimin e vendit tonë.

12 PY. Mesa dini ju, ka pas ndonjë politikë UÇK-ja që të  
13 ushtronte dhunë ndaj anëtarëve të UÇK-së?

14 PË. Në asnjë rrethanë dhe kurrë nuk kam dëgju për diçka të  
15 tillë.

16 PY. Tani do t'ju bëj disa pyetje për ofensivën serbe që ka  
17 ndodh në prill '99.

18 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Për palët në sallën e  
19 gjyqit do t'u referohem transkriptit që keni dhënë dëshmi --  
20 dëshminë tuaj në një çështje tjetër këtu. Është me numër  
21 P01767.1 dhe .2.

22 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që gjatë intervistës me ZPS-në  
23 por dhe dëshminë që keni dhënë në çështjen tjetër gjyqësore  
24 këtu, ju kanë bërë disa pyetje për ofensivën serbe që ka  
25 ndodhur në prill '99, veçanërisht se ofensiva që filloi më 18



1 prill. A ju kujtohet kjo?

2 PË. Po.

3 PY. Ju thatë se keni marrë pjesë aktivisht në luftimet gjatë  
4 asaj ofensive, kështu?

5 PË. E saktë, po.

6 PY. Ju gjithashtu keni thënë se ditën e katërt të ofensivës e  
7 kam fjalën - po referohem faqes 2079 - ju thatë se u tërhoqët  
8 drejt Prishtinës për të mos lejuar humbje më të mëdha  
9 njerëzore, kështu?

10 PË. Lejuam tërheqjen e popullatës civile sepse garantohej  
11 nga të gjitha anët dhe patëm humbje të mëdha të civilëve. Nuk  
12 -- ajo ofensivë nuk ka kursyer as pleq, gra ose të sëmurë. Ka  
13 djegur shtëpitë. Të gjitha shtëpitë e regjionit tonë janë  
14 djegur në atë ofensivë. Janë djegur njerëzit e gjallë në te  
15 dhe ne nuk e kemi penguar depërtimin ose kthimin e popullatës  
16 civile drejt Prishtinës për arsye të masakrave që po  
17 kërcënoheshim, sepse ne nuk mund t'i bënim ballë më asaj  
18 ofensive e cila kishte filluar me forcat jashtëzakonisht të  
19 mëdha dhe në disfavor me forcat tona.

20 Ndërsa njësitet tona të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i  
21 përcollën popullatën civile dhe i lejuan që të depërton drejt  
22 Prishtinës, ku në Makoc është bërë njëra ndër masakrat më të  
23 mëdha në Kosovë ku janë vrarë njerëz, janë nxjerrë nga kolona  
24 dhe janë pre edhe me motoshallë. Janë masakru shumë njerëz  
25 aty. Është njëra ndër masakrat më të mëdha në Kosovë, që është

1 bo si hakmarrje ndaj asaj popullatës që qëndronte atje dhe na  
2 përkrahte neve, dhe është bërë si hakmarrje ndaj luftimeve që  
3 kishin ndodh në terrenin ku vepronim ne.

4 PË. Në fakt, Dëshmitar, ju keni dhënë dëshmi se forcat serbe  
5 po masakronin civilë, përfshirë këtu fëmijë, gra dhe të  
6 moshuar. A është e saktë kjo?

7 PË. E saktë.

8 PY. Dëshmitar, keni dëshmuar që ditën e tretë të ofensivës  
9 rreth datës 20 prill, forcat serbe kanë hyrë në Zllash dhe  
10 kanë sunduar Zllashin. A është kështu, Dëshmitar, a ka ndodhur  
11 kjo me datë 20 prill 1999?

12 PË. Kanë depërtuar, po.

13 PY. Gjithashtu keni dhënë dëshmi që gjatë të gjithë kohës ju  
14 keni qëndruar në Zllash, apo jo?

15 PË. E vërtetë, po.

16 PY. Po ashtu keni thënë që jeni në dijeni se forcat serbe  
17 kanë mbërritur në çdo çikë në Zllash. Këtë thënë apo jo, që  
18 depërtuan në çdo çikë në Zllash?

19 PË. Po.

20 PY. Gjithashtu keni thënë në dëshminë tuaj se forcat serbe  
21 janë futur në çdo shtëpi në Zllash, përfshirë këtu edhe  
22 shtëpinë e Adem Krasniqit. Pra, shtëpinë e familjes të Adem  
23 Krasniqit, a është e saktë kjo?

24 PË. Në të gjitha shtëpitë kanë hyrë dhe që të gjitha i kanë  
25 djegur.

1 PY. Konkretisht ju keni thënë, Dëshmitar, se ata janë futur  
2 gjithashtu edhe në shtëpinë e Krasniqve. A është e saktë kjo?

3 PË. Po, e vërtetë është, edhe me njësi tankiste edhe këmbë.

4 PY. Dëshmitar, mbështetur në njohuritë që keni ju për  
5 ngjarjen dhe mënyrën se si kanë operuar forcat serbe, a  
6 pajtoheni me mua se kishte shumë gjasa që serbët të kishin  
7 vrarë të gjithë civilët që do kishin gjetur në shtëpitë në të  
8 cilat janë futur në Zllash në atë periudhë?

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kërkon spekulim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

11 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Në fakt doja që t'i  
12 përgjigjesha kundërshtimit, megjithatë përderisa e vendosët  
13 për rrëzim, do e perifrazoj ndryshe pyetjen.

14 PY. Dëshmitar, a jeni në dijeni të ndonjë gjëje që i ka  
15 ndodhur civilëve në ndonjë prej shtëpive ku janë futur serbët  
16 gjatë asaj periudhe?

17 PË. Keni njohuri, kemi pas vrasje, kemi pas edhe nga distanca  
18 po edhe pasi kanë hyrë nëpër ndërtesat, nëpër shtëpitë tona.

19 Kanë vra, kanë pushkatu njerëz, kanë vra, kanë djegë njerëz  
20 mbrena. Kemi në rastin Zllash, në Marevc ku njerëzit janë  
21 djeg, janë vra dhe janë djeg brenda në shtëpi. Kemi raste që  
22 janë vra rrugëve brenda shtëpive, shumë masakra edhe në  
23 terren. Mirëpo masakrën më të madhe masanej e kanë zhvilluar  
24 në rrugën Prishtinë -- Zllash-Prishtinë, ma konkretisht në  
25 Makovc ku ishte njëra ndër masakrat më të mëdha.

1 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam pyetje të tjera për ju.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Ka pyetje plotësuese nga Prokurori?

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ndoshta një ose dy pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të vazhdoni.

6 Pyetje vijuese nga z. Michalczuk:

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

8 PY. Z. Sopi, në përgjigje të pyetjes së bërë nga kolegja ime,  
9 nga avokatja e z. Thaçi, ju thatë se nuk kishte disiplinë në  
10 Brigadën 153 ose në njësitet e tjera të cilat më pas u bënë  
11 pjesë e Brigadës 153. Dua që t'i referohet dëshmisë në  
12 gjykimin, në çështjen kundër Mustafës.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe për procesverbal, të  
14 nderuar Gjykatës, është prova P0617.1 [Sipas përkthimit],  
15 faqja e parë.

16 PY. Dhe dua t'ju kujtoj që kjo ka qenë biseda që ka ndodhur  
17 me Prokurorin sa i takon disiplinës. E kemi diskutuar bashkë  
18 këtë gjë. Ju thoni, domethënë, diskutimi është si më poshtë:

19 “.. në momentin që -- përpara sesa të krijohet brigada a  
20 ka pas çështje discipline?”

21 Ju thoni:

22 “Disiplina ka qenë e pranishme që në fillim fare. Që kur  
23 janë krijuar njësitet ...”

24 Më pas ju thoni që:

25 “Ka pas disiplinë në nivel brigade, njësiti, këto

1 rregulla kanë qenë gjithmonë në fuqi.”

2 A e konfirmoni se ma keni thënë këtë gjatë dëshminë në  
3 sallën e gjyqit kur ju kam pyetur, Dëshmitar?

4 PË. Jo, është e vërtetë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka  
5 qenë e vetëdisiplinuar dhe çdo njësi e ka pas disiplinën e  
6 vet, normal. Çdo njësi e mbajt disiplinën e vet dhe të gjithë  
7 ushtarët mbasi që kanë qenë vullnetarë ata kanë qenë të  
8 vetdisiplinuar dhe nuk ka pas nevojë për disiplinë shtesë.  
9 Normal që ka pas disiplinë, edhe të rreptë. Vetëdisiplinë.

10 PY. Z. Sopi, Mbrojtja e z. Krasniqi, gjithashtu ju bëri një  
11 pyetje lidhur me udhëzimet ose hyrjen e forcave serbe në  
12 shtëpinë e Azem Krasniqit. A i ke parë ti vetë me sytë tuaja  
13 forcat serbe që të futeshin në shtëpinë e Adem Krasniqit gjatë  
14 ofensivës së prillit '99? Pyetja është: A i keni parë me sytë  
15 tuaj forcat serbe që të futeshin në shtëpinë e Adem Krasniqit?

16 PË. Po, i kemi parë se ne nuk kemi -- ne vazhdimisht me një  
17 njësi unë kam qëndruar në Zllash dhe e kam depërtimin e tyre  
18 në çdo çikë. Mirëpo nuk kam dashtë që t'i rrezikoj ushtarët  
19 pasi që e kam pa që popullata civile është tërhekur nga  
20 Zllashi, dhe nuk e kam pa të arsyeshëm që t'ju dalin ne  
21 tankseve përpara dhe të vetëflijoheshin përderisa nuk kishim  
22 mo çfarë të mbrojmë. Ndërsa depërtimin e tyre në secilën  
23 shtëpi e kam vrojtuar nga distanca.

24 PY. Çfarë distance ka pasur nga pozita juaj, nga aty ku keni  
25 qenë juve dhe kur i keni parë forcat serbe kur të jenë futur

1 në shtëpinë e Adem Krasniqit?

2 PË. Nuk mund ta caktoj tash distancën, por ne i kemi pas edhe  
3 dylbi, i kemi vrojtuar me dylbi çdo lëvizje të tyre dhe në  
4 mbrëmje ne veç në bazë, ku janë stacionu ata na jemi shku dhe  
5 në atë kuptimin i kemi sulmu. Kemi bo -- i kemi gjujt. Në  
6 mbrëmje, natën.

7 PY. Dëshmitar, pyetja ime ishte kjo: A e keni parë ju  
8 momentin kur forcat serbe janë futur në shtëpinë e braktisur?  
9 Ti vetë moment e ke parë me sytë tuaj?

10 PË. Jo. ne nuk e kemi pa çdo, çdo, çdo sekuençë, nuk e kemi  
11 pa çdo lëvizje të tyre po e dimë se aty çdokund kanë depërtu,  
12 gjithkund.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera, të  
14 nderuar Gjykatës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
16 Gjykatësi Barthe.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

18 Pyetje nga Trupi Gjykses:

19 Mirëdita, Z. Sopi.

20 DËSHMITARI: Mirëdita.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëgjoni mirë?

22 DËSHMITARI: Po.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam një pyetje të shkurtër  
24 për ju. Pyetja ka të bëjë lidhur me atë çfarë keni thënë ju  
25 gjatë dëshmisë në gjykimin kundër Mustafës në vitin 2022. Në

1 atë dëshmi ju keni thënë që në atë kohë keni qenë kryetari i  
2 degës së Prishtinës për shoqatën e veteranëve të luftës së  
3 UÇK-së. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Për cilën periudhë thoni, z. Gjykatës?

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në 2022, me 18 janar 2022,  
6 dhe këtë e keni thënë në raport të provës P0176 [Sipas  
7 përkthimit]. Pra, në rreshtat 15 deri në 16 në dëshminë tuaj  
8 ju keni thënë që në janar 2022, keni qenë kryetar i shoqatës  
9 së veteranëve të luftës së UÇK-së. Pyetje ime për ju është  
10 kjo: E ke akoma këtë post? Je akoma kryetar i shoqatës së  
11 veteranëve të luftës?

12 PË. Kam qenë dhe akoma jam kryetar i organizatës së  
13 veteranëve të luftës për degën e Prishtinës.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Shumë faleminderit. Nuk kam  
15 pyetje të tjera.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje të  
17 tjera? Ka pyetje plotësuese pas pyetjes së Gjykatësit Barthe?  
18 Nuk ka. Në rregull.

19 Dëshmitar. Përfundam me dëshminë tuaj. Mund të largoheni  
20 nga salla e gjyqit. Nuk keni më detyrim përpara nesh. Ju  
21 falënderojmë që ishit sot dhe që dhatë dëshminë tuaj.

22 DËSHMITARI: Faleminderit.

23 [Mikrofoni çaktivizuar].

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 [Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës]

1 këshillohen]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na duhet të  
3 bëjmë një pushim prej 30 minutash në mënyrë që të fillojmë me  
4 dëshmitarin e radhës. Do bëjmë pushim për 30 minuta, pastaj do  
5 fillojmë dhe do bëjmë aq sa mundemi deri në orën 1.00, siç e  
6 bëjmë zakonisht kur kemi seancë. Do bëjmë pushim për 30 minuta  
7 tani. Atëherë, do kemi pushim deri në orën një pa njëzet.

8 --- Seanca ndërpritet në orën 12.12

9 --- Seanca rifillon në orën 12.42

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Ellis.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përpara sesa të  
12 fillojmë me dëshminë e dëshmitarit të radhës --

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe një herë.

15 Përpara sesa të fillojmë me dëshmitarin e radhës  
16 dëshirojmë që të themi diçka për procesverbal, përkatësisht që  
17 të premtën pasdite rreth orës 5.00 pasdite ne jemi njoftuar  
18 për parashtrimin 2676 që janë dy -- tre shtojca, në fakt, që  
19 përmbajnë rreth 450 faqe të materialit që kanë të bëjnë me  
20 dëshmitarët e radhës, me tre dëshmitarët në vijim.

21 Në fakt, neve i kemi kërkuar Prokurores që të na jepej më  
22 shumë kohë që të shtynte për më tepër dëshmitë e këtyre  
23 dëshmitarë në mënyrë të tillë që të kemi mundësi që të lexonim  
24 materiale që lidhen me ta. Prokuroria e rrëzoi këtë kërkesë  
25 tonën. Ne jemi në gjendje që të mund të vijomë sot dhe nesër,



1 megjithatë që procesverbal të themi që është pamundur që të  
2 lexohen 450 faqe materiale për dëshmitarët e planifikuar të  
3 hënën, të martën apo të mërkurën.

4 Kështu që thjesht ne në qoftë se ndodh diçka e tillë në  
5 të ardhmen, nuk kemi asnjë lloj opsioni tjetër por thjesht  
6 mund të kërkojmë shtyrjen e procesit. Ndërkohë që material që  
7 na është dhënë Prokuroria është një material që ata e kanë  
8 pasur prej kohësh në dispozicion dhe nuk na e kanë shpërndarë  
9 ne.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka një  
11 përgjigje Prokuroria?

12 Z. CAPIN: [Mikrofoni çaktivizuar].

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 Z. CAPIN: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 [Përkthim] Më dëgjoni tani?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Atëherë, sa për të qenë të qartë,  
18 besoj që duhet më mirë të kalojmë në seancë private në qoftë  
19 se palët pajtohen.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 Z. CAPIN: [Përkthim] Për shkak të nevojës së shpjegimeve  
22 që lidhen me materialet dhe për shkak të masave mbrojtëse që  
23 janë në pajtim me rregullin 107.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 Z. CAPIN: [Përkthim] Ne si Prokurori mendojmë që dëshmitë

1 e dëshmitarëve të Prokurorisë, qoftë ky dëshmitari i radhës  
2 dhe dëshmitari tjetër, kanë të bëjnë me besueshmërinë e tyre.

3 A jemi në seancë private apo jo?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk jemi  
5 në seancë private.

6 Z. CAPIN: [Përkthim] Më lejoni të kalojmë në seancë  
7 private për t'ju dhënë më shumë shpjegime.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë  
9 në seancë private atëherë.

10 Mund të vazhdoni, ju lutem.

11 [Seancë private]

12 [Seancë private teksti i fshirë]

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

- 1 [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

- 1 [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

25 jemi në seancë publike.



1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
2 pushim deri në orën 2.30.

3 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.07

4 --- Seanca rifillon në orën 14.42

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Znj. Rowan, një sekondë,  
6 ju lutem. Mund të vazhdoni.

7 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ju falënderoj  
8 diçka e shkurtër para se të fillojë dëshmitari.

9 Ju thatë sot në mëngjes, i nderuar Gjykatës, në rreshtin  
10 1820 të transkriptit të mëngjesit, ju thatë që:

11 "Jeni të shoqëruar nga një përfaqësues i ..."

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jemi në seancë publike,  
13 znj. Rowan.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po.

15 "Me miratimin e Panelit, ju mund të konsultoheni me  
16 përfaqësuesin tuaj lidhur me dëshminë."

17 ZPS-ja në aplikimin e saj nuk ka kërkuar që ky dëshmitar  
18 të ketë mundësinë që ky dëshmitar të konsultojë një  
19 përfaqësues dhe këtë s'e ka bërë as edhe Trupi Gjykses, i cili  
20 nuk ka nxjerrë vendim, që ky dëshmitar mund të konsultohet me  
21 përfaqësuesin e tij.

22 Sipas mendimit tonë, i nderuar Gjykatës, ky është një  
23 dëshmitar si gjithë të tjerët dhe të gjithë dëshmitarët marrin  
24 të njëjtin paralajmërim nga Trupi Gjykses, që me të filluar  
25 dëshminë e tyre ata nuk mund ta diskutojnë atë me askënd

1 jashtë sallës së gjykimit. E njëjta gjë ka vlerë edhe në këtë  
2 rast.

3 Përfaqësuesi, sipas rregullës 107, është këtu i pranishëm  
4 për shkak të një shqetësimi të sigurisë kombëtare. Në qoftë se  
5 ndodh një gjë e tillë apo tregohet një dokument i tillë, ky  
6 përfaqësues mund ta ngrejë këtë çështje me Trupin Gjykses dhe  
7 kjo çështje mund të diskutohet në seancë të hapur. Por sipas  
8 mendimit tonë ky dëshmitar nuk ka të drejtën që ta diskutojë  
9 dëshminë e tij apo provat e tij me asnjë përfaqësues tjetër  
10 jashtë kësaj salle, përfshirë edhe këtë përfaqësues.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
12 Ka ndonjë përgjigje?

13 Z. CAPIN: [Përkthim] Sipas të them se ne nuk kemi asnjë  
14 qëndrim. Unë i kam kuptuar këtë udhëzimin e Trupit Gjykses se  
15 në qoftë se dëshmitari mendon që dëshmia e tij del jashtë asaj  
16 që e lejohet të japë dëshmi, pra, përtej asaj që ka pranuar  
17 ushtruesi, dhënësi i informacionit atëherë duhet të ketë të  
18 drejtën që të konsultojë përfaqësuesin.

19 I nderuar Gjykatës, duhet të kalojmë në seancë të mbyllur  
20 për këtë çështje?

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Përpara se të vazhdojmë me  
22 dëshminë e këtij dëshmitari. Do të kërkonim që duke qenë që ky  
23 dëshmitari nuk i është bërë ky paralajmërim, duhet të  
24 paralajmërohet tani që nuk do të duhet ta diskutojë dëshminë e  
25 tij me dhënësin e informacionit. Ky është qëndrimi ynë. Ne

1 kërkojmë që kjo të bëhet jo vetëm me këtë dëshmitar, po dhe me  
2 dy dëshmitarët e tjerë të cilët do të vijjnë që të jetë e qartë  
3 që të gjithë këta dëshmitarë gjatë pushimeve nuk mund ta  
4 diskutojnë informacionin e tyre me dhënësin e informacionit.

5 Z. CAPIN: [Përkthim] Nuk kemi ndonjë kundërshtim, i  
6 nderuar Gjykatës.

7 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 Z. TULLY: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, jo unë kam një  
10 çështje thjesht logjistike.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
12 që na e sollët në vëmendje një gjë të tillë. Ne do të  
13 vazhdojmë ta mbikëqyrim situatën e cila ndodhet përpara nesh.  
14 Dhe në qoftë se dikush, në qoftë se ndodh ndonjë komunikim ne  
15 do të ndërhyjmë dhe do ta zgjidhim këtë çështje në momentin e  
16 duhur. Sigurisht që ne do ta njoftojmë atë, siç bëj gjithnjë  
17 gjatë fundit të ditës, që nuk mund të diskutojnë dëshminë e  
18 tij me asnjë person tjetër.

19 Unë nuk po argumentoj më qëndrimin që keni ju. Por që do  
20 ta mbajmë në mbikëqyrje gjatë gjithë kësaj kohe, jo përpara  
21 kohe.

22 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.  
23 Jam mirënjohëse. E vetmja gjë që do të kërkoja për këtë  
24 dëshmitar është që ne ta paralajmërojmë këtë dëshmitar në  
25 fillim pasi kemi pushime gjatë gjithë kohës, do të duhet t'i

1 bëjmë dëshmitarit tjetër që -- do ta bëjmë me dëshmitarin  
2 gjatë ditës së nesërme që të mos e diskutojë atë gjatë  
3 pushimit të kafesë.

4 Dhe prandaj do t'i kërkoja, do t'ju kërkoj ju, të nderuar  
5 Gjykatës, që të fillim të dëshmisë, ju t'i bëni këtë  
6 paralajmërim që kjo çështje nuk do të diskutohet me asnjë  
7 person përfshirë edhe dhënësin e informacionit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta mbajmë  
9 këtë parasysh, por e kam shqetësimin tënd përpara sysh.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po, është thjesht i njëjti  
11 paralajmërim që u bëhet të gjithë dëshmitarëve.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj. Por  
13 është një rrethanë e veçantë kur një dëshmitar diskuton në  
14 këto kushte.

15 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po nuk ka bazë ligjore për ta  
16 lejuar një gjë të tillë, prandaj duhet të marrim masa për të  
17 mos e lejuar një gjë të tillë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ka disa,  
19 ka disa, ka një formulim lidhur me këtë precedent që sipas  
20 rregullit 107.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, jo nuk është,  
22 nuk ekziston kjo në legjislacion.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk do ta  
24 diskutojmë këtë çështje. E kemi parasysh qëndrimin tuaj.

25 Z. TULLY: [Përkthim] Një çështje e vogël.

1 Lidhur me rendin e pyetjeve të bëra nga pala  
2 kundërshtare. E di që unë kam thënë që do të isha unë i pari,  
3 por ka ndryshuar diçka. Së pari, por ka një ndryshim i cili do  
4 të jetë që së pari do të jetë Selimi, Ekipi i Selimit, pastaj  
5 i Veselit, pastaj i Krasniqit dhe pastaj i Thaçit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
7 Besoj se do të më rikujtohen në kohën e duhur dhe e mbajmë  
8 këtë parasysh, pra, ju, Veseli, Krasniqi dhe Thaçi në fund.

9 Z. TULLY: [Përkthim] Po, ashtu është, i nderuar Gjykatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 Znj. Asistente e Gjykatës, mund ta sillni dëshmitarin  
12 tani në sallë.

13 Z. CAPIN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, besoj se do të  
14 kalojmë në seancë private sapo të vijë dëshmitari.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

16 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit përmes  
17 videolidhjes]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
19 uleni.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]  
21 Sa për njoftim, të nderuar Gjykatës, në vendin në largësi të  
22 pranishëm është përfaqësuesi, Dëshmitari W295 dhe përfaqësuesi  
23 i rregullës 107 dhe unë si zyrtare.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Do të kalojmë në seancë private.

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 102

- 1 [Seancë private]
- 2 [Seancë private teksti i fshirë]
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 110

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 112

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



- 1 [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 114

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 115

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

5 --- Seanca ndërpritet në orën 15.31

6 --- Seanca rifillon në orën 15.42

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare, ju lutem, mund ta sillni dëshmitarin në sallën ku  
9 jeni.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të uleni  
12 të gjithë.

13 Tani do të vazhdojmë me pyetjen e Prokurorit.

14 Z. CAPIN: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

15 Z. CAPIN: [Përkthim] Përpara sesa të vazhdojmë me pyetjet  
16 duhet të kalojmë në seancë private.

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Po.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 118

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 119

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Capin

Faqe 121

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

- 1 [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

- 1 [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

- 1 [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 128

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 129

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 130

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 132

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 133

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04854 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 136

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
8 kemi kaluar në seancë publike.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca  
10 mbyllet. Shihemi nesër në orën 09.00.

11 --- Seanca mbyllet në orën 16.31

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25